



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 131

Tiranë – E martë, 24 shtator 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 44/2019, datë 18.7.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 11127
Ligj nr. 53/2019, datë 18.7.2019	Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë..... 11133
Vendim i Kuvendit nr. 107/2019, datë 19.9.2019	Për rrëzimin e dekretit nr. 11 248, datë 5.8.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 44/2019 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar”..... 11139
Vendim i Kuvendit nr. 108/2019, datë 19.9.2019	Për rrëzimin e dekretit nr. 11 256, datë 8.8.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 53/2019 ‘Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë’”..... 11140
Vendim i Kuvendit nr. 110/2019, datë 19.9.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 11140
Vendim i Kuvendit nr. 111/2019, datë 19.9.2019	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 11140
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 11.9.2019	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) dhe tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të një pjese të pronës nr. 912, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në Vlorë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 11141
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 8.7.2019	Për një shtesë në udhëzimin nr. 3/1, datë 15.4.2019 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar..... 11150

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 423, datë 23.5.2019	Për “Miratimin e rregullore ‘Për miratimin e fletudhëzuesit në gjuhën shqipe’”.....	11150
Urdhër i përbashkët i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 440, datë 11.9.2019	Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit në fushën e turizmit dhe mjedisit.....	11158
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 128, datë 29.8.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 1668 kw.....	11158
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 129, datë 29.8.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike...	11161
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 130, datë 29.8.2019	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).....	11162
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 131, datë 29.8.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Electral Batra HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	11163
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 132, datë 29.8.2019	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e miratimit të draftit të rregullore së lidhjeve të reja në rrjetin e gazit natyror.....	11164
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 134, datë 6.9.2019	Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë Albpetrol sh.a., për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.....	11166
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 135, datë 6.9.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Electral Batra HPP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Selita”, me kapacitet të instaluar 1798 kw, HEC “Frankthi”, 2129 kw dhe HEC “Batra”, 2411 kw, me kapacitet total të instaluar 6338 kw.....	11167
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 136, datë 6.9.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Ensco Trading (Albania)” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	11170
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 137, datë 6.9.2019	Mbi kërkesën e OST sh.a. për disa ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.....	11171
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 138, datë 16.9.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2019.....	11174
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetases Suella Buça.....	11176



LIGJ
Nr. 44/2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995,
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 50, pas shkronjës “f” shtohet shkronja f/1 me këtë përmbajtje:

“f/1. Kur vepra është drejtuar ndaj personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë, për shkak të detyrës.”.

Neni 2

Neni 96 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 96

Neglizhenca në trajtimin mjekësor

Neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve nga ana e profesionistit shëndetësor, kur ka rrezikuar jetën e personit, apo ka dëmtuar rëndë shëndetin e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar vdekjen e personit, dënohet me burgim deri në dy vjet.”.

¹ Ky ligj është përfaqësuar pjesërisht me Direktivën 2008/99/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”, numri CELEX 32008L0099, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 328, datë 6.12.2008, faqe 28-37.

Neni 3

Neni 121 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 121

Ndërhyrje të padrejta në jetën private

Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi ose regjistrimi i fjalëve, fiksimi ose regjistrimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim i të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit, pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Shpërndarja, ofrimi për publikim apo publikimi me çdo mjet ose formë të komunikimit publik apo mënyrë tjetër i të dhënave të marra në mënyrë e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet ndaj personave të mitur, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik apo nga personi që disponon këto të dhëna për shkak të detyrës shtetërore apo shërbimit publik, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.”.

Neni 4

Neni 149 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 149

Shkelja e të drejtave të autorit

Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht, shpërndarja, komunikimi në publik, shitja, ofrimi për shitje, përdorimi, furnizimi, eksportimi ose importimi për qëllime fitimi i veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit, pa pëlqimin e autorit ose mbajtësit të së drejtës, kur janë shkelur të drejtat vetjake ose pasurore të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim deri në tre vjet.”.

Neni 5

Neni 197 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 197

**Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të
lojërave të fatit
në kundërshtim me ligjin**

Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po kjo vepër, nëse në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik, që ka lidhje me veprimtarinë e lojërave të fatit, dënimi me burgim shtohet me një të katërtën e dënimit të dhënë.”

Neni 6

Neni 201 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 201

Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës

Ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimi i rëndë i kafshëve ose i bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialeve në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara me ligj, dënohen me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur është kryer në zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e lehtë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.

Kur kjo vepër ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e rëndë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë vdekjen e një ose disa personave,

dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

Neni 7

Pas nenit 201, shtohen nenet 201/a, 201/b, 201/c dhe 201/ç me këtë përmbajtje:

“Neni 201/a

Menaxhimi i mbetjeve

Grumbullimi, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e venddepozitimeve, si dhe veprimet e ndërmarra në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Ku nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 201/b

Transportimi i mbetjeve

Transportimi i mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i Shqipërisë, në sasi jo të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-tjetrin, në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose burgim deri në pesë vjet.

Neni 201/c

Aktivitetet e rrezikshme

Funksionimi i një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet



kompetente, të cilat shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë dëme të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Po kjo vepër, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Neni 201/ç

Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme

Prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Po kjo vepër kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.”

Neni 8

Neni 202 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 202

Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër

Vrasja, shkatërrimi, zotërimi, marrja e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e

mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.”

Neni 9

Pas nenit 202 shtohen nenet 202/a dhe 202/b me këtë përmbajtje:

“Neni 202/a

Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër

Tregtimi i ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Neni 202/b

Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore

Veprimet që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.”

Neni 10

Neni 203 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 203

Substancat ozonholluese

Prodhimi, importimi, eksportimi, nxjerrja në treg ose përdorimi i substancave ozonholluese, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo



të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.”.

Neni 11

Pas nenit 207 shtohen nenet 207/a, 207/b, 207/c dhe 207/ç me këtë përmbajtje:

“Neni 207/a

Braktisja e kafshës të shoqërimit

Kur nga braktisja e kafshës së shoqërimit ose nga mosvendosja e maskës mbrojtëse kafshës së shoqërimit, në ambiente publike ose në mjedise të hapura për publikun, kanë ardhur pasoja në dëm të shëndetit të një personi, dënohet me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj.

Kur nga vepra penale ka ardhur plagosja e rëndë e një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur nga vepra penale ka ardhur vdekja e një personi, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 207/b

Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit

Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Neni 207/c

Keqtrajtimi i kafshës

Keqtrajtimi ose torturimi i një kafshe, duke i shkaktuar dëmtime të përhershme shëndetësore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e kafshës, dënohet me burgim deri në gjashtë muaj.

Neni 207/ç

Ndeshjet ndërmjet kafshëve

Promovimi, organizimi ose drejtimi i ndeshjeve ndërmjet kafshëve që shkaktojnë vuajtjen ose torturimin e kafshëve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Dhënia e kafshëve për ndeshje, rritja ose trajnimi i kafshëve me qëllim përdorimin apo

shitjen për ndeshje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Vënia e basteve në ndeshje të zhvilluara midis kafshëve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy muaj.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e kafshës, dënohet me burgim deri në gjashtë muaj.”.

Neni 12

Neni 237 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 237

Goditjet për shkak të detyrës

Goditjet ose vepra të tjera dhune ndaj punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore apo të shërbimit publik, dënohen me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj personit të zgjedhur apo funksionarit publik, për shkak të veprimtarisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj punonjësit të policisë për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj profesionistit shëndetësor për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën shtetërore, funksionin publik apo shërbimin publik, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet.”.

Neni 13

Neni 238 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 238

Kanosja për shkak të detyrës

Kanosja serioze për vrasje apo për plagosje të rëndë, që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, dënohet me burgim deri në dy vjet.



Kur kjo vepër kryhet ndaj personit të zgjedhur apo funksionarit publik për shkak të veprimtarisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj punonjësit të policisë për shkak të veprimtarisë së tij, kur cilësitë e personit janë të njohura ose të dukshme, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj profesionistit shëndetësor për shkak të veprimtarisë së tij, kur cilësitë e personit janë të njohura ose të dukshme, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën shtetërore, funksionin apo shërbimin publik, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.”

Neni 14

Në nenin 274 “Prishja e qetësisë publike”, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Ushtrimi i veprimtarisë ekonomike që lëshon/gjeneron zhurmë në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj, që cenon dukshëm qetësinë në zona të banuara ose në mjedise publike, kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.”

Neni 15

Pas nenit 274 shtohen nenet 274/a dhe 274/b me këtë përmbajtje:

“Neni 274/a

Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv

Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, nga persona jashtë kësaj veprimtarie, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në ambiente sportive, më shumë se një herë, apo është kryer nga drejtues apo anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 274/b

Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive

Hyrja në fushën e lojës, gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv, nga persona të paautorizuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

Kur nga kjo vepër ka ardhur pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.”

Neni 16

Në nenin 278, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyes ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në shtatë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet më shumë se një herë ose në sasi të mëdha, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

Neni 17

Pas nenit 278/a shtohet neni 278/b me këtë përmbajtje:

“Neni 278/b

Prodhimi, mbajtja, tregtimi i armëve bërthamore ose kimike

Prodhimi, mbajtja, tregtimi i armëve bërthamore ose kimike të dëmtimit në masë të popullsisë, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet.”

Neni 18

Në nenin 282 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:



“Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse dhe djegëse”.

2. Në paragrafin e parë hiqen fjalët “apo radioaktive”.

3. Në paragrafin e parë, pas fjalëve “lëndëve plasëse” shenja e pikësimit “presje” ndryshohet në “ose”.

Neni 19

Në nenin 282/a bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese”.

2. Në paragrafin e parë hiqen fjalët “dhe radioaktive”.

3. Në paragrafin e parë, pas fjalës “djegëse” shenja e pikësimit “presje” ndryshohet në “ose”.

Neni 20

Neni 288 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 288

Importimi, prodhimi, shitja dhe ruajtja e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin ose jetën e njerëzve

Importimi, prodhimi, ruajtja, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër i ushqimeve ose futja në prodhimin e artikujve ushqimorë e kimikateve, materialeve apo lëndëve shtesë, që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve, në shkelje të kërkesave të legjislacionit të posaçëm, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kur nga kjo vepër ka ardhur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet e pesë vjet.”.

Neni 21

Pas nenit 288/b shtohen nenet 288/c dhe 288/ç me këtë përmbajtje:

“Neni 288/c

Mashtrimi me produktet ushqimore

Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, falsifikimi, shitja apo vendosja në qarkullim në

Faqe | 11132

ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, materialeve ose lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë, në të cilët janë shënuar të dhëna të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, sasisë apo cilësisë së produktit apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, ose paraqitja e të dhënave të rreme në etiketimin e produkteve ushqimore, që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 288/ç

Prishja e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore

Prishja me dashje e shenjave të sigurisë, të vendosura nga organet shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore për qëllime mbikëqyrjeje, kontrolli ose pezullimi të veprimtarisë tregtare në mjediset ekonomike, mbi mjetet e transportit ose mbi mallra, me qëllim lëvizjen e mallrave ushqimore ose rifillimin e aktivitetit, dënohet me burgim deri në tre vjet.”.

Neni 22

Neni 293 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 293

Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit

Vënia e pengesave ose ndalimi, me çdo mjet e mënyrë, i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujor e ajror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 18.7.2019



LIGJ
Nr. 53/2019

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kuadrit ligjor për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, në vijim Akademia.

Neni 2
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rolit të Akademisë, i organeve përbërëse të saj dhe i atyre që veprojnë pranë saj, si dhe rregullimi i marrëdhënieve të Akademisë me institucionet e tjera të kërkimit shkencor e të politikave të zhvillimit të saj.

Neni 3
Akademia

1. Akademia është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish.

2. Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit, që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit.

3. Akademia, si person juridik, përbëhet nga trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, që në këtë ligj do të quhet Asamble.

4. Selia e Akademisë është në Tiranë. Ajo ka logon dhe simbolet e saj zyrtare.

Neni 4

Roli dhe funksionet kryesore të Akademisë

1. Të pranojë si anëtarë në radhët e saj dijetarë, krijues e kërkues të shquar në fushën e shkencës dhe të kulturës, të cilët përmbushin standarde të larta në lidhje me personalitetin, punën dhe reputacionin në shkencë e kulturë.

2. Të kontribuojë e të promovojë arritjet e kërkimit shkencor dhe të propozojë fusha të reja kërkimore e studimore në përputhje me përparësitë e nevojat e zhvillimit të vendit.

3. Të ndërtojë strategji dhe zbatojë politika për përdorimin e njëzuar të gjuhës shqipe zyrtare, të terminologjive bashkëkohore të shkencës dhe teknikës, si dhe për konsolidimin e gjuhës shqipe në të gjitha fushat e shkencës.

4. Të këshillojë e të ndihmojë me rekomandime, ekspertiza e opionenca Qeverinë dhe institucionet qendrore për aspekte të rëndësishme të kërkimit shkencor, të formimit të specialistëve të lartë dhe të planifikimit të projekteve të së ardhmes.

5. Të kontribuojë në promovimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të shkencëtarëve të rinj.

6. Të nxisë dhe udhëheqë krijimin e njësive të veçanta të kërkimit, si dhe të hartimit të strategjive të zhvillimit të shkencës e të kërkimit shkencor.

7. Të promovojë, botojë dhe shpërndajë standardet e reja ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe të inovacionit, si dhe të garantojë respektimin e tyre për vlerësimin e punës shkencore dhe etikës në shkencë, si dhe për mbështetjen e programeve të studimit apo kërkimit.

8. Të botojë organe periodike dhe vepra të tjera me nivel të lartë ndikimi shkencor.

9. Të bashkëpunojë me institucionet e vendit me kapacitet kërkimi, si institucionet e arsimit të lartë, institutet dhe qendrat e kërkimit, me qëllim koordinimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e kërkuesve të rinj.

10. Të bashkëpunojë me institucionet analoge jashtë vendit për promovimin e arritjeve dhe për



tërheqjen e projekteve të përbashkëta, për diplomacinë shkencore dhe për të përfaqësuar në shkallë ndërkombëtare komunitetin shkencor shqiptar.

11. Të organizojë kongrese, konferenca e simpoziume shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

12. Të ruajë, të dokumentojë dhe të përcjellë trashëgiminë akademike, përmes botimeve përmbledhëse të veprave të figurave më të spikatura, zhvillimit të aktiviteteve, ekspozitave dhe muzeve të ngritura në përputhje me legjislacionin përkatës.

13. Të propozojë metoda e kritere për matjen dhe vlerësimin objektiv të cilësisë dhe kontributeve në procesin e kërkimit shkencor pranë ministrisë përkatëse, komisionit të Kuvendit apo Këshillit të Ministrave.

14. Të orientojë fushat dhe nënfushat prioritare, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shkencën, për kërkimet shkencore të doktoratës. Të analizojë arritjet dhe problematikat e këtyre kërkimeve dhe të hartojë në çdo dy vjet një raport publik për to.

15. Të inkurajojë si prioritet të kërkimit shkencor zhvillimin e programeve të studimit me karakter ndërdisiplinor dhe të mbrojë deontologjinë e tij.

16. Të promovojë identitetin kombëtar nëpërmjet përafrimit gjithmonë e më të ngushtë me akademitë shqiptare në rajon.

17. Të ndërtojë strategji dhe zbatojë politika për zhvillimin e shkencave të albanologjisë dhe për promovimin e arritjeve të tyre brenda dhe jashtë vendit.

18. Të ndërtojë strategji dhe zbatojë politika për përdorimin e njehsuar të gjuhës shqipe në funksionet zyrtare.

19. Të garantojë që zgjedhjet e anëtarëve të Asamblesë zhvillohen në përputhje me parimin e barazisë gjinore, duke synuar progresivisht balancën gjinore të përfaqësimit.

Neni 5

Përbërja e Akademisë

1. Akademia si institucion përbëhet nga organet e saj drejtuese:

- a) Asambleja;
- b) Kryesia;
- c) Kryetari.

Faqe | 11134

2. Akademia përfshin edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë saj, si:

- a) seksione;
- b) komisione;
- c) njësi të kërkim-studimit;
- ç) Akademia e të Rinjve;
- d) biblioteka;
- dh) enti botues;
- e) administrata ndihmëse.

KREU II

PËRBËRJA DHE DETYRAT E ASAMBLESE

Neni 6

Asambleja

1. Asambleja është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, e cila përbëhet nga akademikë dhe akademikë të asociuar, të cilët do të quhen anëtarë të Asamblesë. Numri i akademikëve është deri në 30, ndërsa numri i akademikëve të asociuar është deri në 10.

2. Anëtarët zgjidhen nga Asambleja ndër mbajtësit e titullit “Profesor”, që kanë një kontribut të veçantë me një ndikim të gjithëpranuar në fushën përkatëse, në bazë të kandidaturave të përzgjedhura nëpërmjet procedurave e kritereve të përcaktuara në statutin e Akademisë. Në procedurat e kandidimit e të përzgjedhjes përfshihen edhe struktura apo përfaqësues të institucioneve të kërkimit shkencor, të arsimit të lartë e të kulturës. Në raste të veçanta, anëtarë zgjidhen personalitete me kontribut të spikatur nga fusha e krijimtarisë artistike, kulturës dhe jetës sociale në përgjithësi. Si rregull, akademikët zgjidhen nga radhët e akademikëve të asociuar. Në rast kandidimi të drejtpërdrejtë, kandidati duhet të marrë mbështetjen e jo më pak se 2/3-ve të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë.

3. Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personat me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës e të kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas joshqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, gjuhës e kulturës shqiptare. Numri i anëtarëve të nderit



është deri në 15, i anëtarëve të jashtëm deri në 10 dhe i anëtarëve korrespondente deri në 15. Personat me origjinë shqiptare që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të “All European Academies”, fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave, e cila formalizohet nga një mbledhje ceremoniale e Asamblesë. Këta të fundit nuk përfshihen në llogaritjen e kufirit maksimal të sipërcituar.

4. Anëtarët e Asamblesë që mbushin moshën 75 vjeç marrin statusin e anëtarit “Emeritus”. Ata nuk përfshihen në llogaritjen e kufizimeve të pikës 1 të këtij neni.

5. Personat e zgjedhur sipas këtij neni quhen “Anëtarë të Akademisë”.

Neni 7

Detyrat e Asamblesë

Asambleja kryen këto detyra:

1. Zgjedh anëtarët e Akademisë.
2. Zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin, sekretarin shkencor dhe drejtuesit e seksioneve.
3. Miraton projektbuxhetin vjetor, pas përgatitjes së tij nga Kryesia, dhe ia dërgon Kuvendit për miratim.
4. Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Akademisë për vitin përmbyllës pas përgatitjes së tij nga Kryesia.
5. Miraton programin e punës për vitin pasardhës, si dhe programet afatgjata e strategjitë e zhvillimit.
6. Miraton statutin dhe ndryshimet e tij me 2/3 e votave.
7. Miraton marrëveshjet që nënshkruan Akademia me të tretët, sipas përcaktimeve në statut.
8. Përcakton llojet e çmimeve shkencore dhe kriteret e dhënies së tyre.
9. Miraton aderimin e Akademisë në organizata apo bashkime ndërkombëtare me natyrë shkencore.
10. Kryen edhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga statuti.

Neni 8

Mbledhjet e Asamblesë

1. Si rregull, Asambleja mbledhet dy herë në vit.

2. Zgjedhjet për anëtarët e rinj të Kryesisë zhvillohen gjithmonë në fund të vitit, përveç rasteve të mbetjes së vendeve të lira në organet drejtuese, sipas përcaktimeve në statut.

3. Çdo vit Asambleja zhvillon një mbledhje të zgjeruar të saj për miratimin e projektbuxhetit, programit dhe raportit vjetor të saj.

4. Mbledhjet e Asamblesë janë të vlefshme kur në to merr pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të saj.

5. Vendimi me shumicë të thjeshtë merret kur për të voton “pro” më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

6. Zgjedhjet për personat që ushtrojnë kompetencat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 7, të këtij ligji, bëhen me votim të fshehtë dhe me shumicë absolute të të gjithë anëtarëve.

7. Mospjesëmarrja e “anëtarëve emeritus” nuk cenon arritjen e kuorumit apo përcaktimin e shumicave të cilësuar.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Asamblesë

Anëtarët e Asamblesë kanë këto të drejta dhe detyra:

1. Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet drejtuese dhe në strukturat në përbërje ose pranë Akademisë.
2. Të marrin pjesë aktive në mbledhjet e Asamblesë, të seksioneve dhe të komisioneve.
3. Të luajnë rol aktiv në stimulimin dhe promovimin e shkencës e të kërkimit shkencor në institucionet ku punojnë apo në fushën përkatëse.
4. Të zbatojnë detyrat që u janë dhënë nga Asambleja, Kryesia, kryetari, kryetarët e seksioneve apo komisioni përkatës.
5. Të marrin pjesë aktive në kongreset, konferencat e veprimtaritë zyrtare të Akademisë dhe të organeve të saj.
6. Të kërkojnë dhe të marrin informacion për punën shkencore, planet dhe programet e përgatitura nga institucionet e arsimit të lartë dhe nga institucionet kërkimore për fushën që mbulojnë.
7. Të japin ekspertizë dhe këshillime për institucionet publike të shkencës dhe të arsimit.



8. Të marrin pjesë në njësitë apo grupet e punës për studimin, hartimin dhe kërkimin në fusha të caktuara.

9. Të përfaqësojnë Akademinë e Shkencave në komisione, borde dhe këshilla ekspertize me karakter ndërinstitucional.

10. “Anëtarët emeritus” përjashtohen nga detyrimet e pikës 2, të këtij neni, dhe nga e drejta për t'u zgjedhur në organet drejtuese.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të tjerë

Anëtarët e jashtëm, të nderit dhe ata korrespondentë kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë dhe në të gjithë aktivitetet e Akademisë. Me pëlqimin e tyre, ata aktivizohen dhe kontribuojnë në plotësimin e detyrave të Akademisë dhe të anëtarëve të saj, të parashikuara në nenet 4 dhe 9 të këtij ligji.

KREU III

ORGANET EKZEKUTIVE

Neni 11

Zgjedhja e Kryesisë

1. Kryesia është organ ekzekutiv i Akademisë.

2. Kryesia përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve.

3. Asambleja zgjedh me votim të fshehtë për një mandat 4-vjeçar Kryetarin e Akademisë.

4. Zgjedhja e Kryetarit i Akademisë bëhet nga anëtarët e Asamblesë drejtpërdrejt dhe me votim të fshehtë. Kryetar i Akademisë zgjidhet akademiku që fiton shumicën absolute të votave të anëtarëve të Asamblesë. Në rast se asnjë kandidat nuk fiton shumicën absolute të votave, votimi përsëritet dhe kandidati që fiton më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm zgjidhet Kryetar i Akademisë.

5. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin e Asamblesë, emëron kryetarin e zgjedhur prej saj.

6. Kur Presidenti i Republikës vendos mosemërimin e kryetarit të zgjedhur, dekreti i Presidentit e humbet fuqinë nëse nuk mbështetet nga shumica e të gjithë anëtarëve të Asamblesë.

7. Në rastin e parashikuar në pikën 6, të këtij neni, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kryetari i

zgjedhur shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Asamblesë ose nga data e mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 5 të këtij neni.

8. Zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve zgjidhen drejtpërdrejt nga Asambleja, me votim të fshehtë, me shumicën absolute të votave.

9. Mandati i zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa ai sekretarit shkencor dhe drejtuesve të seksioneve është 5 vjet.

10. Kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor dhe drejtuesit e seksioneve mund të rizgjidhen në të njëjtën funksion për dy mandate, por jo radhazi.

11. Kriteret dhe procedura e zgjedhjes së Kryesisë përcaktohen në Statutin e Akademisë.

Neni 12

Detyrat dhe kompetencat e Kryesisë

1. Detyrat dhe kompetencat e Kryesisë janë:

a) organizon dhe drejton Akademinë në bazë e në zbatim të këtij ligji, statutit të saj dhe vendimeve të Asamblesë;

b) ndjek dhe organizon punën e seksioneve, komisioneve, si dhe të njërive të ngritura pranë Akademisë;

c) organizon dhe drejton punën e administratës së Akademisë, përfshirë edhe entin botues, sipas rregullores së brendshme të funksionimit të saj;

ç) përgatit projektprogramin dhe projektbuxhetin;

d) përgatit mbledhjet e Asamblesë;

dh) përgatit raportin vjetor.

2. Për kryerjen e detyrave të saj, Kryesia nxjerr vendime të brendshme. Vendimet e brendshme merren me shumicë të thjeshtë. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit është përcaktuese.

3. Detyrat e zëvendëskryetarit, sekretarit shkencor dhe drejtuesve të seksioneve përcaktohen në Statutin e Akademisë.

Neni 13

Kryetari

1. Detyrat e kryetarit janë:

a) drejton dhe organizon punën e veprimtarinë e Akademisë e të Kryesisë;



b) përfaqëson Akademinë në marrëdhënie me të tretët dhe nënshkruan në emër të saj;

c) raporton në Asamble për aktivitetin e përgjithshëm;

ç) raporton në Kryesi për aktivitetin semestral;

d) drejton mbledhjet e Asamblesë;

dh) nënshkruan vendimet e Kryesisë dhe të Asamblesë;

e) zbaton detyrat e përcaktuara në statut.

2. Në zbatimin e detyrave dhe kompetencave të tij, Kryetari nxjerr urdhra të brendshëm.

KREU IV VLEFSHMËRIA, PAPAJTUESHMËRITË DHE NDËRPRERJA E MANDATEVE

Neni 14 Vlefshmëria

1. Me zgjedhjen si anëtar i Asamblesë, personi fiton titullin “akademik” ose “akademik i asociuar”.

2. Titujt “akademik” dhe “akademik i asociuar” janë tituj akademikë e si të tillë hiqen vetëm në rastet e ndërprerjes së mandateve të parashikuara në këtë ligj apo me vendim gjykate.

3. Titujt “akademik” dhe “akademik i asociuar” përfitojnë një shpërblim mujor të përhershëm për titull në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Kur një anëtar i Asamblesë shkon me banim të përhershëm jashtë vendit, atëherë ai kalon në statusin “anëtar korrespondent”. Në rast rikthimi, rifiton statusin e mëparshëm.

Neni 15 Ndalesat dhe papajtueshmëria

1. Anëtarë të Asamblesë mund të zgjidhen personat deri në moshën 68 vjeç për titullin “akademik” dhe deri në 65 vjeç për titullin “akademik i asociuar”.

2. Personat që ushtrojnë funksione drejtuese në institucionet kushtetuese apo në partitë politike nuk mund të zgjidhen anëtarë të Asamblesë.

3. Personat që ushtrojnë detyra të larta drejtuese shtetërore ose në partitë politike, sipas përcaktimeve në statut, nuk mund të zgjidhen anëtarë të Kryesisë.

4. Anëtarët e Kryesisë nuk mund të ushtrojnë funksion tjetër me kohë të plotë.

Neni 16 Ndërprerja e mandateve

1. Mandati i anëtarit të Akademisë ndërpritet për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) jep dorëheqjen;

b) për komprometim të rëndë të figurës së akademikut, për shkelje të parimeve të deontologjisë ose për shkaqe të parashikuara në ligj;

c) për pamundësi të ushtrimit të funksionit.

2. Mandati i anëtarit të Kryesisë ndërpritet për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) jep dorëheqjen;

b) pranon të zgjidhet ose emërohet në një funksion të papajtueshëm, të parashikuar në nenin 15, pikat 3,4, të këtij ligji;

c) mbush moshën 75 vjeç;

ç) shkarkohet nga Asambleja me 2/3 e votave për shkelje të rënda në ushtrimin e detyrës.

3. Në rastet e tjera kryetari zëvendësohet përkohësisht nga zëvendëskryetari, ndërsa anëtarët e tjerë nga një person i caktuar nga Kryesia.

KREU V STRUKTURAT E NJËSITË NDIHMËSE

Neni 17 Seksionet

1. Me qëllim organizimin e punës dhe realizimin e funksioneve të saj, anëtarët e Asamblesë organizohen në seksione, sipas grup-fushave kryesore.

2. Asambleja përcakton numrin e seksioneve që do të funksionojnë pranë Akademisë.

3. Detyrat, përgjegjësitë, përbërja, mënyra e drejtimit dhe e funksionimit të tyre përcaktohen në Statutin e Akademisë.

4. Seksionet mbledhen jo më pak se 4 herë në vit.

Neni 18 Komisionet

1. Pranë Akademisë ngrihen komisione të përhershme ose të posaçme.

2. Në përbërje të komisioneve ka si anëtarë, përveç akademikëve, edhe përfaqësues të institucioneve dhe qendrave të kërkimit shkencor dhe të arsimit të lartë.



3. Komisionet e përhershme ngrihen sipas fushave.

4. Numri, emërtimi, lloji, objekti dhe detyrat e tyre caktohen në Statutin e Akademisë.

5. Komisionet e posaçme ngrihen me vendim të Kryesisë, sipas përcaktimeve në statut.

Neni 19

Njësitë e kërkim-studimit

1. Sipas nevojave, detyrave e problemeve në fushën e kërkimit, në përmbushje të rolit të saj, pranë Akademisë mund të ngrihen njësi të kërkim-studimit me aktivitet afatshkurtër e afatgjatë.

2. Këto njësi janë autonome në realizimin e detyrave të tyre, mbajnë marrëdhënie me Kryesinë e Kryetarin dhe raportojnë pranë tyre.

3. Sipas rëndësisë, problemeve e kohëzgjatjes, këto njësi ngrihen me akte të Asamblesë apo të Kryesisë për njësitë me afat deri në 2 vjet dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësitë e tjera.

4. Objekti i tyre, financimi, shtrirja, veprimtaria dhe përbërja përcaktohen në aktet përkatëse që dalin për ngritjen e tyre.

Neni 20

Akademia e të Rinjve

1. Me qëllim inkurajimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë kërkimore-shkencore të kërkuesve të rinj dhe për vendosjen e një ure komunikimi dhe promovimi me ta, funksionon Akademia e të Rinjve, si organ këshillues e bashkëpunues pranë Akademisë. Akademia e të Rinjve ka deri në 20 anëtarë, të zgjedhur nga radhët e kërkuesve të rinj me gradën shkencore “doktor”. Mandati si anëtar është 4–7 vjet dhe ndërpritet në moshën 40 vjeç.

2. Në përbërjen e saj synohet përfaqësimi nga të gjitha fushat kryesore të dijes, kulturës e shkencës.

3. Anëtarët e Akademisë së të Rinjve përfaqësohen në komisionet e Akademisë, marrin pjesë në mbledhjet e seksioneve, si dhe një përfaqësi prej 3–4 personash nga radhët e tyre marrin pjesë në mbledhjen vjetore të Asamblesë, ku miratohet raporti, plani vjetor e projektbuxheti i Akademisë së Shkencave.

4. Akademia e të Rinjve funksionon si një organizëm autonom në bazë të një statuti të miratuar prej saj dhe me vendim të Kryesisë.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

Marrëdhëniet me institucionet shtetërore

1. Akademia, brenda tremujorit të parë të çdo viti, dërgon pranë Këshillit të Ministrave dhe komisionit parlamentar përkatës raportin e veprimtarisë vjetore të punës së saj për vitin paraardhës.

2. Në mbledhjen e saj vjetore për miratimin e programit të punës së Akademisë, ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve kryesore të kërkimit dhe të Këshillit të Ministrave.

3. Një herë në vit organizohet dialogu shkencë-politikë ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe Këshillit të Ministrave, sipas një marrëveshjeje dypalëshe.

Neni 22

Administrata

1. Kryesia e Akademisë, në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe për kryerjen e shërbimeve administrative, profesionale e teknike, mbështetet nga administrata e Akademisë.

2. Kancelari është autoriteti më i lartë administrativ i Akademisë.

3. Zgjedhja e kancelarit dhe punonjësve të administratës rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil, duke e njësuar pozicionin e kancelarit me atë të Sekretarit të Përgjithshëm në ministri.

4. Kancelari kryen këto funksione:

a) harton projektbuxhetin vjetor mbi bazën e propozimeve të seksioneve dhe mbështetur në strategjinë e zhvillimit të institucionit;

b) drejton procedurat e prokurimit të buxhetit dhe është urdhërues i tij;

c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit;

ç) i paraqet Asamblesë raportin vjetor mbi veprimtarinë financiare të institucionit;

d) detyra të tjera të kancelarit përcaktohen në statut dhe në rregulloret e institucionit.

5. Struktura, organika dhe niveli i pagave për administratën përcaktohen nga Asambleja me propozim të Kryesisë, e cila ia paraqet Kuvendit për miratim.



Neni 23 Financimi

1. Akademia është institucion buxhetor.
2. Veprimtaria e saj financohet nga:
 - a) buxheti i shtetit;
 - b) shërbimet tekniko-shkencore që kryen për persona juridikë e fizikë jashtë sistemit të saj;
 - c) aplikimet, projektet, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Të ardhurat nga pikat “b” dhe “c”, të këtij neni, nuk zvogëlojnë buxhetin e përgjithshëm, sipas pikës “a” dhe ato përdoren sipas rregullores së brendshme të Akademisë.
4. Projektbuxheti i Akademisë i dërgohet për miratim Kuvendit.

Neni 24 Statuti i Akademisë

Rregullat, procedurat dhe kriteret e detajuara për organizimin dhe funksionimin e Akademisë përcaktohen në Statutin e Akademisë.

Neni 25 Dispozita kalimtare

1. Ngarkohet Akademia e Shkencave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë ndryshimet në statutin e saj në përputhje me këtë ligj.
2. Deri në miratimin e këtyre ndryshimeve do të zbatohet statuti që është në fuqi, për aq sa dispozitat e tij nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.
3. Mandatet e anëtarëve të Akademisë së të Rinjve, të ngritur me vendimin e Kryesisë nr. 14, datë 7 qershor 2017, janë të vlefshme deri në përfundimin e afatit të tyre.
4. Anëtarësimet e reja në Akademinë e të Rinjve do të bëhen pas miratimit të statutit të ri sipas këtij ligji.
5. Ngarkohet Akademia që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, t’i propozojë Kuvendit për miratim strukturën, organikën dhe nivelin e pagave për administratën e saj.

Neni 26 Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9655 datë 11.12.2006, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 27 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 18.7.2019.

VENDIM Nr. 107/2019

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11 248, DATË 5.8.2019, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 44/2019 ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, ‘KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 248, datë 5.8.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 44/2019 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 19.9.2019.

**VENDIM**
Nr. 108/2019**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11
256, DATË 8.8.2019, TË PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E
LIGJIT NR. 53/2019 ‘PËR AKADEMINË
E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 256, datë 8.8.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 53/2019 ‘Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë’”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 19.9.2019.

VENDIM
Nr. 110/2019**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 90/2017
“PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të

Faqe | 11140

përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Eljo Hysko largohet nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare dhe caktohet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

2. Deputetja Artemis Dralo largohet nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe caktohet në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 19.9.2019.

VENDIM
Nr. 111/2019**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 100/2017
“PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE
ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN
E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21/1 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

1. Deputetja Artemis Dralo caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Integrimin Europian.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 19.9.2019.

**VENDIM****Nr. 605, datë 11.9.2019**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË
SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA
E MBROJTJES TEK AGJENCIA
SHTETËRORE E KADASTRËS (ASHK)
DHE TEK AGJENCIA E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA), TË NJË PJESE
TË PRONËS NR. 912, ME EMËRTIM
“SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME
VENDNDODHJE NË VLORË, DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.
515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të një pjese të pronës nr. 912, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në Vlorë, nga Ministria e Mbrojtjes tek Agjencia e Shtetërore e Kadastrës (ASHK), përkatësisht, të një pjese të katit përdhes, me sipërfaqe 343 (treqind e dyzet e tre) m², të katit të parë dhe katit të dytë të godinës kryesore të kësaj prone, të objekteve “Garazh” dhe “Depo qymyri”, si dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1 273 (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) m², sipas planrilevimeve dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’i përdorur për nevoja administrative, për vendosjen e administratës së drejtorisë së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në Vlorë.

2. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të një pjese të katit përdhes të godinës kryesore të pronës nr. 912, me sipërfaqe 372 (treqind e shtatëdhjetë e dy) m², me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ngritjen e një qendre të integruar për ofrimin e shërbimeve publike në qytetin e Vlorës.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet pjesa e pronës nr. 912, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me sipërfaqe prej 1 273 (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) m², së bashku me godinat që shtrihen mbi këtë truall funksional, sipas përcaktimeve në pikat 1 e 2, të këtij vendimi.

4. Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) u ndalohej të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronës, përcaktuar në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin atë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) dhe Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



verifikimet me origjinalin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1358679
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. VLORE Zona Kadastrale Nr. 5605
 Numri i Pasurisë 50/17 Volumi 12 Faqe 69
 Adresa e Pasurisë VLORE
 Lloji i Pasurisë TRUALL
 Sipërfaqja Totale 1673.00 m²
 Nga kjo : Sa Truall 1.673.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 795.00
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>EDURD</u>	<u>EDURD</u>	<u>EDURD</u>	<u>1/1</u>	<u>VURRI</u>

- është pronar i pasurisë me numër 50/17
 - janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
 - kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 22/02/2017 Nr. 4109
 Lëshuesi i çertifikatës
 REGJISTRUESI
REZAR ELMAZI

Data e lëshimit të çertifikatës
22/02/2017



KARTA TREGUES E REGJISTRIMIT

ZVLERPP VLORE

REGJISTRUES
REZART ELMAZIHARTOGRAF
Ing. *[Signature]*

A IDENTIFIKIM I PASURISE

LON-ALBANIA 8605 NR I PASURISE 50/17 VOL 12 FAQ 98

INDIKUESI VL- 63-11 SHKALLA 1.500

ADRESA E KARTES VLORE 1 VLORE 5

NR. 50/17 50/18 50/19 50/20 50/21 50/22 50/23 50/24 50/25 50/26 50/27 50/28 50/29 50/30 50/31 50/32 50/33 50/34 50/35 50/36 50/37 50/38 50/39 50/40 50/41 50/42 50/43 50/44 50/45 50/46 50/47 50/48 50/49 50/50 50/51 50/52 50/53 50/54 50/55 50/56 50/57 50/58 50/59 50/60 50/61 50/62 50/63 50/64 50/65 50/66 50/67 50/68 50/69 50/70 50/71 50/72 50/73 50/74 50/75 50/76 50/77 50/78 50/79 50/80 50/81 50/82 50/83 50/84 50/85 50/86 50/87 50/88 50/89 50/90 50/91 50/92 50/93 50/94 50/95 50/96 50/97 50/98 50/99 50/100

B KUPËZIMET

V 50/6

L 53/1

J 50/2


D 50/67 50/68 50/69 50/70

C PRONARI

SHETET

S1 = 1673 m²S2 = 795 m²

Date: 02.03.2017

VO: DIFERENCA FALF DOCUMENT 52 m²

[illegible]




Planimetria e objektit
Kati dytë
Sipërfaqja TOTALE = 954m²
Shkalla 1:150


MIRATOHET
DREJTORI I SHITESËS QENDRORE TE FA
Në mungesë
KRYETARE E DEGES EKONOMIKE
Elida LEKA



SHITESËS E USHTARAKEVE VLORE
Sq. Kulla - 5.87 = 854m²




REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E NERËTOTJES LOJLILU	2V DREJTORI VIZATOI	ENEA SHUMËRË
PROVA DE SIZ SHITESËS E USHTARAKEVE VLORE	PRERITJE	ERMAL MUSTAJ NALTIN DORR
12.06.2019		



MIRATOHEJ
DREJTORI I SHITESË QENDRORE TE FA
Në mungesë
KRYETARE E DEGËS EKONOMIKE
Elida **LEKA**

© 1998 by E. J. Brill Publishers, Inc.
 660, Route 101, West Nyack, NY 10994

REPUBLIKA E SHQIPËRISE MINISTRIA E MBRËTËRIT 16610	EV DHELEJFURI	EDNA SHINOBIERI	
PRIZHA NR 912 SHËTËJA E URBANIZIMIT VLONË	VIZATORI	EDMAL MUSAI NALTU DOME	
DE GJATA 2019	PRISTITEL		





PLAN RILEVIMI
Prona nr.912 Shtëpia e Ushtrakëve Vlorë

MIRATOHET
DREKTORI I SHQ. TË FA
Në marrëse
KRYETARI I DEGËS EKONOMIKE
ELIDA LEKA

Hartoi
Ing. Ermal MAÇI

Guorr 2019

IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrore 8605
Nr. Paturise Vel. Fq.
Indeksi i Hartes K-34-123-(160-B)
VL-GJ-11
Shkalla 1: 500
Adresa e paturise L. "28 Nëntori", Vlorë
Q.F. Vloër
Proant: Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Qendror dhe FA

ZV/DREKTOR I GJITHU
Ark. Ena **SINOINIERI**

Shpjeguese:

- Sip. e përgjithshme që kërkon rregullim ASHIS-ja — 1273 m²
- Sip. e përgjithshme nën objekta — 797.5 m²

Shënim: Kjo planvendosje u hartua në zbatim të adresës së Shërbimit Qendror të FA nr. 59, datë 26.08.2019, sipas majave të kryera në terren në prani të përfaqësuesve të pronës z. Naim LULI dhe të hedhar mbir HTR.



UDHËZIM

Nr. 7, datë 8.7.2019

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.
3/1, DATË 15.4.2019 “PËR KRITERET,
PROCEDURAT DHE MËNYRËN E
ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 6 dhe 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10. 2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të pikës 5, të VKM-së nr. 128, datë 13.3.2019 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2019”, të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të masës së kompensimit të prodhimeve bujqësore, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 3/1, datë 15.4.2019 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë vijon:

1. Në kreun VIII, masa 9, nënndarja “I”, në shkronjën “I”, në fund të fjalisë, shtohen fjalët:

“Aplikantët që sigurojnë lejet e ndërtimit/rikonstruksionit pas këtij afati, por jo më vonë se data 30.9.2019, renditen në vlerësim pas aplikantëve që kanë siguruar lejet e ndërtimit/rikonstruksionit brenda datës 7.6.2019”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**

**MINISTËR I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj**

URDHËR

Nr. 423, datë 23.5.2019

**PËR “MIRATIMIN E
RREGULLORES “PËR MIRATIMIN E
FLETUDHËZUESIT NË GJUHËN
SHQIPE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në ligjin nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për miratimin e fletudhëzuesit në gjuhën shqipe”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

**RREGULLORE
PËR MIRATIMIN E FLETUDHËZUESIT NË
GJUHËN SHQIPE**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është që të mundësojë dhënien e udhëzimeve, se si informacioni i dhënë në fletudhëzues të jetë i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga kushdo që e lexon, në mënyrë që mjekimi të merret në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme.

2. Kjo rregullore ka për qëllim të asistojë/t’u vijë në ndihmë aplikantë-t/-ve dhe mbajtës-it-ve e autorizimit për tregtim kur të hartojnë fletudhëzuesin.

3. Kjo rregullore jep sugjerime mbi prezantimin e përmbajtjes së fletudhëzuesit dhe mbi dizajnimin dhe konceptet e përgjithshme të cilat do të



ndihmojnë në prodhimin e një informacioni cilësor.

4. Rregullorja gjithashtu përshin informacion mbi mënyrat se si mund të zbatohen sa më shumë kërkesat e alfabetit *braille*, si dhe, se si të bëhet e mundur që fletudhëzuesi të jetë i disponueshëm në formate të përshtatshme për pacientët.

5. Kjo rregullore do të jetë e aplikueshme për të gjitha barnat, përfshirë këtu dhe ato të listës së barnave OTC.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Fletudhëzues” është fletëpalosja që përmban informacion për përdoruesin dhe që shoqëron barin e gatshëm për përdorim.

2. “Aplikant” nënkupton subjektin e autorizuar për aplikim për miratimin e fletudhëzuesit në gjuhën pranë AKBPM-së.

3. “AKBPM” nënkupton Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Neni 3

Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është vendosja e standardeve dhe informacionit të saktë në fletudhëzuesin e barit, si dhe përcaktimin e procedurave për miratimin e tij në gjuhën shqipe nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Neni 4

Konsiderata të përgjithshme

1. Fletudhëzuesi mendohet të përdoret nga pacienti ose përdorues të tjerë. Nëse fletudhëzuesi hartohet mirë dhe në gjuhë të qartë, numri i personave që do ta përdorin si informacion do të rritet, përfshirë këtu fëmijët, adoleshentët, ata që kanë aftësi të varfra në shkrim e lexim si dhe ata që kanë shikueshmëri të ulët deri në një gradë të caktuar.

2. Udhëzimet e mëposhtme japin disa rekomandime mbi aspekte të ndryshme që lidhen me përgatitjen e fletudhëzuesit. Qëllimi është që të ndihmohen aplikantët/mbajtësit e autorizimit për tregtim që të përmbushin të gjitha kërkesat ligjore dhe bazohet në eksperiencën e cila ka treguar se

përdorimi i këtyre teknikave optimizon përdorimin e fletudhëzuesit

KREU II

LEXUESHMËRIA DHE REKOMANDIME PËR FLETUDHËZUESIN

Neni 5

Madhësia dhe lloji i shkrimit

1. Zgjidhni një lloj shkrimi që është i lehtë të lexohet. Stilet e llojeve të shkrimit që janë të vështira të lexohen nuk duhen përdorur. Është e rëndësishme të zgjidhni një lloj shkrimi në të cilin shkronjat dhe numrat e ngjashëm mund të dallohen thjeshtë, si p.sh.: “i”, “l”, “1”.

2. Madhësia e shkrimit duhet të jetë sa më e madhe të jetë e mundur, që t'i ndihmojë lexuesit. Një shkrim me madhësi 9 i llojit *Times New Roman*, jo i ngushtuar, me një hapësirë mes rreshtave minimumi 3 mm, duhet konsideruar si minimum. Gjithsesi, për ata që aplikojnë për marrjen e autorizimit për tregtim një shkrim me madhësi 8 i llojit *Times New Roman*, jo i ngushtuar, me një hapësirë mes rreshtave minimumi 3 mm, duhet të jetë i pranueshëm si minimumi absolut.

3. Duhet konsideruar përdorimet e madhësive të ndryshme të shkrimeve në mënyrë që të bëjë të mundur që informacionet kyçe të dallohen dhe të jenë të thjeshta për t'u kërkuar në tekst (p.sh.: për titujt).

4. Duhet konsideruar përdorimi i shkrimit me përmasa më të mëdha kur një bar synohet specifikisht të përdoret për një indikacion që lidhet me probleme të shikueshmërisë. Nuk duhet të ketë përdorim të gjerë të shkronjave kapitale. Truri i dallon fjalët e një teksti nga forma e tyre, ndaj zgjidhni madhësi të vogla shkrimi në paragrafë teksti të gjatë. Gjithsesi shkronjat kapitale mund të përdoren për të theksuar ndonjë frazë.

5. Mos përdorni shkronja italike dhe nënvijëzime pasi ato e bëjnë më të vështirë për lexuesin të njohë formën e fjalës. Shkronjat italike mund të përdoren në rast të termave në gjuhën latine.

Neni 6

Paraqitja grafike dhe paraqitja e informacionit

1. Në parim, teksti “justified” (teksti i drejtuar në të majtë dhe në të djathtë të kufijve të dokumentit) nuk duhet përdorur.



2. Hapësirat mes rreshtave duhet të jenë të qarta. Hapësira mes rreshtave është një faktor me rëndësi që ndikon në qartësinë e tekstit. Si rregull i përgjithshëm, hapësira mes rreshtave duhet të jetë minimumi 1.5 herë më e madhe se hapësira mes fjalëve në një rresht.

3. Kontrasti mes tekstit dhe sfondit është me mjaft rëndësi. Duhet konsideruar faktorët, si: pesha e letrës, ngjyra e letrës, madhësia dhe gjatësia e shkrimit, ngjyra e shkrimit dhe letra në vetvete. Shumë pak kontrast mes tekstit dhe sfondit prek negativisht aksesueshmërinë e informacionit. Ndaj, imazhet që vendosen në sfond, në parim nuk duhet të vendosen fiks pas tekstit pasi mund të prekin qartësinë e informacionit dhe ta bëjnë atë të vështirë për t'u lexuar.

4. Një tekst në format kolone mund ta ndihmojë lexuesin të kërkojë informacionin. Kufiri mes kolonave duhet të jetë mjaftueshëm i madh që të ndajë tekstin në mënyrë të përshtatshme. Nëse hapësira është e limituar atëherë mund të përdoret një vijë vertikale për të ndarë tekstin. Informacionet e lidhura me njëri-tjetrin duhet të qëndrojnë bashkë në mënyrë që teksti të rrjedhë thjeshtë nga njëra kolonë në tjetrën. Duhet konsideruar përdorimi i një paraqitjeje horizontale, pasi kjo gjë mund ta ndihmojë pacientin.

5. Në rastet kur propozohet përdorimi i një fletudhëzuesi në gjuhë të ndryshme, duhet të ketë një shënim të qartë mes gjuhëve të përdorura; i gjithë informacioni i dhënë në secilën prej gjuhëve duhet mbledhur.

Neni 7 Titujt

1. Titujt janë të rëndësishëm dhe mund të ndihmojnë lexuesin të kërkojë informacionin. Ndaj dhe titujt “bold” ose me ngjyrë tjetër mund të ndihmojnë që ky informacion të theksohet. Hapësira mes dhe poshtë rreshtave duhet aplikuar në mënyrë konstante përgjatë fletudhëzuesit. Titujt duhet të paraqiten në mënyrë konstante në të njëjtën formë dhe renditje në mënyrë që të ndihmojnë lexuesin (numërimi, pikëzimi, gjurmët, lloji dhe madhësia).

2. Përdorimi i më shumë se dy niveleve titujsh duhet konsideruar me kujdes, pasi më shumë se dy mund ta bëjnë të vështirë për lexuesin që të gjejë informacionin që kërkon në fletudhëzues. Gjithsesi

në rast të komunikimit të ndonjë informacioni kompleks, mund të përdoren disa nivele titujsh.

3. Përdorimi i vijave për të ndarë seksione të ndryshme mes tekstit mund të ndihmojë si aksesor në kërkimin e informacionit.

4. Nëntitujt dhe tekstet shoqëruese brenda fletudhëzuesit duhet të përfshihen vetëm nëse janë me rëndësi për barin në fjalë. Për shembull, nëse nuk ka informacion lidhur me efektet e njohura të ndonjë eksipienti, atëherë ky seksion mund të mos përfshihet në fletudhëzues.

Neni 8 Ngjyra e printimit

1. Aksesueshmëria e informacionit nuk përcaktohet vetëm nga madhësia e shkrimit. Karakteret mund të printohen në një ose disa ngjyra në mënyrë që të dallohen lehtësisht nga sfondi. Një madhësi ose ngjyrë e ndryshme është një mënyrë për t'i bërë titujt ose informacione të tjera lehtësisht të dallueshme. Lidhja midis ngjyrave të përdorura është aq e rëndësishme sa ngjyrat në vetvete. Si rregull i përgjithshëm teksti i errët duhet printuar në një sfond të çelët. Por mund të ketë raste kur mund të përdoret e kundërta (tekst i çelët në sfond të errët), për të theksuar për shembull ndonjë paralajmërim të veçantë. Në situata të tilla cilësia e printimit duhet konsideruar pasi mund të kërkojë përdorimin e një teksti të një madhësie më të madhe ose teksti “bold”.

2. Nuk duhet përdorur ngjyra të ngjashme të tekstit dhe sfondit pasi prekin negativisht lexueshmërinë.

Neni 9 Sintaksa

1. Disa njerëz mund të kenë aftësi të varfra leximi, dhe disa të tjerë aftësi të varfra shkrimi dhe leximi. Synoni përdorimin e fjalëve të thjeshta dhe me pak rrokje. Nuk duhet përdorur fjali të gjata. Është më mirë të përdorni disa fjali se sa një fjali të gjatë, sidomos për informacionet e reja. Paragrafët e gjatë mund t'i konfuzojnë lexuesit, sidomos kur janë të përfshira listat e efekteve të padëshiruara. Përdorimi i pikëzimeve për lista të tilla konsiderohet si më i përshtatshëm. Aty ku është e mundur, nuk duhet përdorur më shumë se 5 deri në 6 pika në një listë.



2. Kur bëhet diferencimi i efekteve të padëshiruara është veçanërisht e rëndësishme të konsiderohet rendi që do të ndiqet në mënyrë që pacienti/përdoruesi të maksimizojë përdorimin e informacionit. Në përgjithësi rekomandohet ndarja e efekteve të padëshiruara sipas frekuencës së ndodhisë së tyre, duke nisur nga frekuenca më e lartë, në mënyrë që dhe individëve t’u komunikohet niveli i riskut. Termat e frekuencës duhet të shpjegohen në mënyrë të tillë që pacientët/përdoruesit t’i kuptojnë, për shembull “shumë e zakonshme” (më shumë se 1 në 10 pacientë).

3. Gjithsesi, aty ku ekziston një efekt i padëshiruar serioz, i cili kërkon që pacienti/përdoruesi të marrë masa të menjëhershme, duhet që ai të shfaqet në fillim të seksionit dhe t’i jepet mjaft rëndësi. Ndarja e efekteve të padëshiruara sipas organeve/ sistemeve/klasave nuk rekomandohet meqenëse pacientët/përdoruesit në përgjithësi nuk janë të familjarizuar me këto klasifikime.

Neni 10

Stili

1. Rekomandohet përdorimi i stilit aktiv në vend të atij pasiv. Për shembull:

- “merr dy tableta” në vend të “2 tableta duhet të merren”

- “ti duhet...” është më mirë se “është e nevojshme që...”

2. Kur pacientëve i thuhet se çfarë veprimesh duhet të ndërmarrin, duhet të jepen gjithashtu dhe arsyet e këtyre veprimeve. Si fillim duhet të paraqiten instruksionet, pastaj arsyetimi p.sh.: “trego kujdes me X nëse vuan nga azma – mund të të shkaktojë atak”.

3. Është më mirë të përdoren terma, si: “Mjekimi juaj, ky mjekim, etj.”, se sa të përsëritet emri i barit, për aq kohë sa ajo çfarë shkruhet në tekst e bën të qartë se kujt po i referohet.

4. Shkurtime dhe akronimet/inicialet nuk duhen përdorur vetëm në rast se kërkohet. Kur përdoren për herë të parë në tekst, duhet të shoqërohen edhe nga emërtimi i plotë të cilit i referohen. Simbolet e ngjashme (p.sh.: >ose<) është e vështirë të kuptohen ndaj edhe nuk duhen përdorur.

5. Termat mjekësorë duhet të përkthehen në një gjuhë që pacientët mund ta kuptojnë. Mënyra se si përkthehen ose shpjegohen këto përkthime duhet të jetë konsistente, duke dhënë termin e përshtatur, me një përshkrim në fillim dhe më pas menjëherë termin mjekësor të detajuar. Në situata ku do të shpjegohen rastet njëri pas tjetrit, termi më i përshtatshëm (mjekësor ose ai i përkthyer), mund të përdoret në të gjithë fletudhëzuesin në mënyrë që të hartohet një tekst i thjeshtë për t’u lexuar.

6. Sigurohuni që gjuha e përdorur të japë një sinjal paralajmërues për lexuesin lidhur me informacionet që janë me mjaft rëndësi për të, dhe të japë mjaftueshëm detaje se si pacienti mundet të njohë një efekt të padëshiruar të mundshëm ose ndonjë veprim që është i nevojshëm të ndërmerret.

Neni 11

Letra

1. Pesha e letres së përdorur duhet të jetë e tillë që letra të jetë mjaftueshëm e trashë, në mënyrë që të reduktohet transparenca, pasi ajo e bën të vështirë leximin, sidomos kur madhësia e tekstit është e vogël. Letra me shkëlqim reflekton dritën dhe e bën informacionin të vështirë për t’u lexuar, ndaj dhe duhet konsideruar përdorimi i një letre të paveshur.

2. Sigurohuni që kur të paloset fletudhëzuesi, vija e palosjes të mos interferojë ose pengojë lexueshmërinë e informacionit.

Neni 12

Përdorimi i simboleve dhe piktogrameve

1. Lejohet përdorimi i imazheve/figurave, piktogrameve dhe grafikëve të tjera që ndihmojnë në kuptimin e informacionit që kërkohet të transmetohet, me përjashtim të elementëve me natyrë promociionale.

2. Simbolet dhe piktogramet mund të përdoren me kusht që simboli të jetë i qartë dhe përmasa e grafikës e bën atë të lehtë të lexohet. Nuk duhet të përdoren me qëllim që të lehtësojnë navigimin, qartësojnë ose theksojnë aspekte të ndryshme në tekst ose të zëvendësojnë tekstin aktual.

3. Mund të kërkohen prova të ndryshme në mënyrë që të sigurojnë se informacioni i tyre është lehtësisht i kuptueshëm dhe jo keqduhëqës.



4. Nëse nuk ka asnjë dyshim lidhur me kuptimin e ndonjë piktogramë, atëherë konsiderohet e përshtatshme për t'u përdorur.

5. Kujdes i veçantë do të nevojitet kur simbolet të transferohen ose të përdoren në versione të gjuhëve të ndryshme të fletudhëzuesit dhe mund të lindë nevoja për testim të mëtejshëm.

Neni 13

Informacione të mëtejshme

1. Llojet e produkteve

a) Në parim, duhet të ketë një fletudhëzues të veçantë për çdo dozë ose formë farmaceutike të një bari. Në situata të përsëritura autoriteti rregullator mund të lejojë përdorimin e fletudhëzuesve të kombinuar për doza të ndryshme dhe/ose forma farmaceutike të ndryshme (p.sh.: tableta, kapsula), për shembull në rastet kur për të arritur dozimin e nevojshëm nevojitet kombinimi i dozave të ndryshme, ose kur doza varion nga njëra ditë në tjetrën në varësi të përgjigjes klinike.

b) Një referencë e thjeshtë ndaj dozave ose formave farmaceutike të tjera, të të njëjtit bar, është gjithmonë e mundur të bëhet nëse është e nevojshme për terapinë.

2. Barnat e administruara nga profesionisti i shëndetit ose në spital

a) Për një bar që do të administrohet nga profesionisti i shëndetit, informacioni i marrë nga përmbledhja e karakteristikave të produktit, për profesionistin e shëndetit (p.sh.: instruksionet për përdorim) mund të përfshihet në fund të fletudhëzuesit të pacientit. Një mënyrë alternative mund të ishte që përmbledhja e karakteristikave të produktit të përfshihej në paketim së bashku me fletudhëzuesin.

b) Për një bar që administrohet në spital, mund të bëhen fletudhëzues shtesë, në bazë të kërkesës në mënyrë që të sigurohet që çdo pacient të marrë informacionin e nevojshëm.

KREU III
APLIKIMI

Neni 14

Praktika e aplikimit

1. Aplikimi për miratimin e fletudhëzuesit në gjuhën shqipe kryhet pranë AKBPM-së nga

subjekti i autorizuar, të cilët këtu më poshtë do të quhen “aplikanti”.

2. Fletudhëzuesi dorëzohet nga aplikanti në gjuhën letrare shqipe dhe në gjuhën angleze në *hard copy* dhe në formë elektronike (CD).

Neni 15

Procedurat dhe dokumentacioni i aplikimit për barnat që aplikojnë për autorizim për tregtim

1. Për aplikimin për miratimin e fletudhëzuesit në gjuhën shqipe, aplikanti duhet të paraqesë pranë AKBPM-së një kërkesë me shkrim si një dokument origjinal në gjuhën shqipe/angleze në të njëjtën kohë me kërkesën për pajisjen me *certifikatën e autorizimit për tregtim* në RSH, si dhe mandatin e pagesës të lëshuar nga banka, për kryerjen paraprakisht të pagesës së caktuar si tarifë për aplikimin. (tarifa propozohet nga Ministri për Shëndetësinë, nëse ky miratim do të bëhet nëpërmjet një tarife).

2. Aplikanti duhet të dorëzojë fletudhëzuesin në gjuhën angleze të dorëzuar për marrjen e autorizimit për tregtim në RSH dhe fletudhëzuesin e përkthyer në gjuhën shqipe letrare pranë AKBPM-së, si dhe duke u mbështetur në fjalorin bashkëngjitur kësaj rregulloreje, aneksi 1.

3. Fletudhëzuesi duhet të paraqitet në format Word me shkrimin Times New Roman 12.

4. Agjencia miraton fletudhëzuesin në gjuhën shqipe brenda 30 ditëve pas aplikimit të suksesshëm.

5. Në rast të mosrespektimit të pikave 1, 2, 3, Agjencia refuzon aplikimin për miratim e fletudhëzuesit në gjuhën shqipe.

6. Pas miratimit të fletudhëzuesit në gjuhën shqipe, çdo përditësim do të bëhet nëpërmjet procedurave rregullatore, bazuar në VKM nr. 299, datë 8.4.2015, të ndryshuar.

7. Barnat e përmendura në VKM nr. 299, datë 8.4.2015, të ndryshuar, neni 14, pika 5, përjashtohen nga ky udhëzim/rregullore. Gjithashtu përjashtohen nga ky rregullore barnat orfan (jetimë), si dhe barnat të cilat kanë një import vjetor nën 5000 kuti.

8. Subjekti përgjegjës për procesin e implementimit të fletudhëzuesve në gjuhën shqipe duhet të deklarohet pranë AKBPM-së nëpërmjet një njoftimi zyrtar nga aplikanti.



9. Implementimi i fletudhëzuesve në gjuhën shqipe do të kryhet brenda një afati 12-mujor nga data e miratimit të fletudhëzuesit.

10. Implementimi i fletudhëzuesit në gjuhën shqipe do të kryhet brenda paketimit dytësor të barit për barnat që kanë import vjetor mbi 10 000 kuti, ndërsa për ato barna, importi vjetor i të cilave shkon nga 5 000 kuti në 10 000 kuti, do të kryhet nga jashtë paketimit dytësor të barit.

Neni 16

Procedura e pajisjes me fletudhëzues në gjuhën shqipe për barnat që janë të autorizuar për tregtim në RSH, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje

1. Aplikanti duhet të paraqesë pranë AKBPM-së një kërkesë me shkrim si një dokument origjinal në gjuhën shqipe/angleze brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi/rregulloreje, si dhe mandatin e pagesës të lëshuar nga banka, për kryerjen paraprakisht të pagesës së caktuar si tarifë për aplikimin (Tarifa propozohet nga Ministri për Shëndetësinë, nëse ky miratim do të bëhet nëpërmjet një tarife.).

2. Aplikanti duhet të dorëzojë fletudhëzuesin e fundit të përditësuar në anglisht të miratuar pranë Agjencisë dhe fletudhëzuesin e përkthyer në gjuhën shqipe letrare pranë AKBPM-së, si dhe duke u

mbështetur në fjalorin bashkëngjitur kësaj rregulloreje, aneksi 1.

3. Fletudhëzuesi duhet të paraqitet në format Word me shkrimin Times New Roman 12.

4. Agjencia miraton fletudhëzuesin në gjuhën shqipe pas aplikimit të suksesshëm.

5. Në rast të mos respektimit të pikave 1, 2, 3 Agjencia refuzon aplikimin për miratim e fletudhëzuesit në gjuhën shqipe.

6. Barnat e përmendura në VKM nr. 299, datë 8.4.2015, të ndryshuar, neni 14, pika 5, përjashtohen nga kjo rregullore. Gjithashtu përjashtohen nga kjo rregullore barnat orfan (jetimë), si dhe barnat të cilat kanë një import vjetor nën 5000 kuti.

7. Subjekti përgjegjës për procesin e implementimit të fletudhëzuesve në gjuhën shqipe duhet të deklarohet pranë AKBPM-së nëpërmjet një njoftimi zyrtar nga aplikanti.

8. Implementimi i fletudhëzuesve në gjuhën shqipe do të kryhet brenda një afati 12-mujor nga data e miratimit të fletudhëzuesit.

9. Implementimi i fletudhëzuesit në gjuhën shqipe do të kryhet brenda paketimit dytësor të barit për barnat që kanë import vjetor mbi 10 000 kuti, ndërsa për ato barna, importi vjetor i të cilave shkon nga 5 000 kuti në 10 000 kuti do të kryhet nga jashtë paketimit dytësor të barit.

FJALOR

Fjala në anglisht

A

active substance
activity
administration
adverse event
adverse reaction, adverse effect, side effect, undesirable effect
allergic-type hypersensitivity reactions
alternative treatment
ATC code

B

biotransformation
blister
bioavailability
body mass index
body mass
body weight

Fjala në shqip

lëndë aktive
aktivitet
administrim
ngjarje e padëshiruar
reaksion i padëshiruar, efekt negativ, efekt anësor, efekt i padëshiruar
reaksione të mbindjeshmërisë, të tipit alergjik
trajtim alternativ
kodi ATC

biotransformim
blister
biodisponibilitet
indeksi i masës trupore
masa trupore
pesha trupore

**C**

cause

shkak

D

disease

sëmundje

distribution

shpërndarje

dosage

dozim

dosage form

formëdozë

drug

bar

E

effectiveness

efektshmëri

efficacy

efikasitet

elimination

eliminim

excretion

ekskretim

exposure

ekspozim

extension

zgjatje, shtrirje

F

faeces

feçe, jashtëqitje

failure

dështim

fatigue

lodhje

fever

temperaturë

first line treatment

trajtimi linjës së parë

H

half- life

gjysmëjetë

hypersensitivity

mbindjeshmëri

hypertension

hipertension

hypotension

hipotension

hypotonia

hipotoni

I

impairment

dëmtim

index

indeks

infection

infeksion

infusion

infuzion

inhalation

inhalacion

inhaler

inhalator

inhibitor

inhibitor

insomnia

pagjumësi

insufficiency

pamjaftueshmëri

interaction

ndërveprim

L

labelling

etiketim

level

nivel

loading dose

doza e ngarkimit

M

maintenance dose

doze mbajtëse

medical device

pajisje mjekësore

medicinal product

bar

medicine

bar

monitoring

monitorim

monitoring for signs and symptoms

monitorim i shenjave dhe simptomave

multiple dose

dozë e shumëfishtë

**N**

nausea

nauze

newborn

i porsalindur

O

obstipation

overdose

P

package leaflet

fletudhëzues

packaging, outer

paketim i jashtëm

packaging, immediate

paketim parësor

pharmaceutical form

formë farmaceutike

placebo effect

efekti placebo

preclinical

paraklinik

product information

informacioni i produktit

S

safety

siguri

sign

shenja

single dose

dozë e vetme

symptom

simptoma

solubility

tretshmëri

stage

stad

starting dose

doze fillestare

steady-state

gjendje e qëndrueshme

subcutaneous

subkutane

subject

subjekt

sublingual

sublingual

Summary of Product Characteristics

përmbledhje e karakteristikave të produktit

syndrome

sindromë

T

therapeutic

terapeutik

therapy

terapi

tolerability of the drug

tolerancë e barit

topical

lokal

toxic dose

dozë toksike

treatment

trajtım

U

user

përdorues

V

validated

e validuar

variable

e ndryshueshme

volunteer

vullnetar

vs (versus)

përkundrejt

W

worsening

përkeqësim

**URDHËR I PËRBASHKËT**
Nr. 440, datë 11.9.2019**PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE
TË OFRUARA ME ÇMIME TË
REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT
TË KARTËS SË STUDENTIT NË
FUSHËN E TURIZMIT DHE MJEDISIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 2, të vendimit nr. 226, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetëror edhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e shërbimit me tarifë zero për hyrjen e studentëve, në zonat e përcaktuara sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I TURIZMIT
DHE MJEDISIT**
Blendi Klosi

**MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË**
Besa Shahini

Lidhja nr.1

1. Shërbimi i hyrjes me tarifë zero për hyrjen e studentëve në zonat si më poshtë:

- a) Parku Kombëtar Mali i Dajtit (hyrja me postbllok);
- b) Monumenti Natyror Syri i Kaltër;
- c) Parku natyror Kune–Vain–Tale.

VENDIM
Nr. 128, datë 29.8.2019**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “MP-HEC”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “NIÇË”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1668 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 1, 3 dhe 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2019, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “MP-HEC” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 79/1, datë 16.8.2019 për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, nga HEC “Niçe”, me kapacitet të instaluar 1668 kW,

konstatoi se:

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 492 prot, datë 26.7.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Niçe”, me kapacitet të instaluar 1668 kW.

- Aplikimi i shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.



- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2, pika 4.1.3, pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria “MP-HEC” sh.p.k, është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8 të Kontratës Koncesionare të formës BOT, me nr. 311 rep. dhe nr. 45 kol, datë 2.2.2009 “Për ndërtimin e HEC “Niçë”, të lidhur ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërisë “DEVY” sh.p.k me “ZYFI” sh.p.k, në cilësinë e Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në zbatim të VKM-së nr. 217, datë 21.2.2008 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të Hec “Niçë”.

- Nga sa konstatuar nga Kontrata e Koncesionit të formës BOT sipërcituar, kohëzgjatja e saj do të jetë 35 vjet nga data e efektive, me të drejtë ripërsëritje.

- “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” në nenin 10, pika 4, parashikon se ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4, të nenit 8, të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

- Në pikën 4, të nenit 8, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes se lejeve nga institucionet e tjera.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “b”):

Rezulton se shoqëria ka plotësuar të dhënat në lidhje me Selinë qendrore, drejtuesin kryesor

të tij dhe të deleguarin përgjegjës, por në vijim duhet të paraqesë në ERE, prokurën e përfaqësimit të aplikuesit.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “e” (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, por duhet të paraqesë në ERE strukturën e ndërtimit të shoqërisë.

- Neni 9, pika 2, germa “f” (Marrëveshje Koncesioni ose autorizimi nga KM në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës), shoqëria ka paraqitur:

- Kontratën e Koncesionit për ndërtimin e Hidrocentralit “Niçë”, me fuqi të instaluar 600 kW, nr. 311 rep. dhe nr. 45 kol, datë 2.2.2009, të nënshkruar ndërmjet METE dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “DEVY” sh.p.k. dhe “ZYFI” sh.p.k.

- Kontratën Shtesë të Koncesionit për ndërtimin e Hidrocentralit “Niçë”, nr. 4431 rep. dhe nr. 1999 kol, datë 9.6.2012, të nënshkruar ndërmjet METE dhe MP-HEC sh.p.k. Në të citohet se: “Koncesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin brenda 32 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit. Afati i ndërtimit është 10 muaj si e parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në aneksin 2, bashkëlidhur”.

- Kontratën shtesë të koncesionit për ndërtimin e Hidrocentralit “Niçë”, nr. 288 rep. dhe nr. 92 kol, datë 12.5.2015, të nënshkruar ndërmjet MEI dhe shoqërisë “Energy Albania Group” sh.p.k., nga ku palët bien dakort se: 1) pas titullit të paragrafi i parë i kontratës, fjalët “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” të zëvendësohen me fjalët “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”; 2) Koncesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin brenda muajit dhjetor 2016.

- Kontratën shtesë të koncesionit për ndërtimin e Hidrocentralit “Niçë”, nr. 750 rep. dhe nr. 251 kol, datë 26.7.2017, të nënshkruar ndërmjet MEI dhe shoqërisë Koncesionare “MP-HEC” sh.p.k., nga ku palët bien dakord se: Koncesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin brenda 9 muajve nga përfundimi i afatit të ndërtimit, i përcaktuar në kontratën shtesë të koncesionit me nr. 288 rep; nr. 92 kol, datë 12.5.2015.



Shoqëria Koncesionare “MP-HEC” sh.p.k., duhet të depozitojë në ERE kontratën shtesë të koncesionit, në vijim të miratimit të projektit të zbatimit të përmirësuar të HEC “Niçë”, kërkuar nga MIE me shkresën nr. 11965/1 prot., datë 13.12.2018.

- Neni 9, pika 2, germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti) - Shoqëria MP-HEC sh.p.k., ka depozituar:

- kontratën e qirasë me nr. 9669 rep. dhe nr. 5663 kol, datë 12.12.2016 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor kombëtar” të lidhur midis Bashkisë Maliq dhe Shoqërisë MP-HEC sh.p.k., për dhënien me qira të sipërfaqes prej 1.3024 ha e ndarë në: 3.066 km shtrirje tubacioni/kanal dhe 0.19 km rrugë ndihmëse. Afati i kësaj kontrate do të jetë deri në vitin 12.12.2025, me të drejtë ripërtëritje, sipas afatit të Kontratës së Koncesionit nr. 311 rep, nr. 45 lol, datë 2.2.2009.

- kontratën e qirasë me nr. 3458 prot, datë 28.9.2017 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor kombëtar” të lidhur midis Bashkisë Pogradec dhe Shoqërisë MP-HEC sh.p.k., për dhënien me qira të sipërfaqes: në cungishtë (tubacion presioni) 1.542 km, rrugë ndihmëse në funksion të ndërtimit të trasesë së vendosjes të tubacionit të presionit 0.31 km, si dhe pakësim në volum e dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 0.412 ha dhe 1.676 ha, për ndërtimin e HEC “Niçë”. Kontrata e Qirasë lidhet për një afat 10-vjeçar duke filluar nga dita e nesërme e nënshkrimit të kontratës dhe palët kanë të drejtë të rinovojnë afatin e kësaj kontrate në zbatim të afatit të Kontratës së Koncesionit nr. 311 kol. dhe nr. 115 rep., datë 2.2.2009.

Shoqëria duhet të saktësojë koordinatat e zonës ku do të ushtrohet veprimtaria.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “c”: dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) - shoqëria duhet të paraqesë në ERE shpjegimet e nevojshme në lidhje me vlerën finale të investuar për ndërtimin e veprës në krahasim edhe me huanë që rezulton në bilanci e saj.

- Neni 9, pika 4.1.4, germa “b” (Grafiku i Zbatimit të Projektit) - duhet depozituar në ERE si pjesë integrale e Kontratës së Koncesionit “aneksi A” i saj, Grafiku e Punimeve, i cili duhet të vijë i përditësuar bashkëlidhur kontratave shtesë të Koncesionit që kanë shtyrë afatet e punimeve, sikurse citohet në to.

Neni 9, pika 4.1.4, germa “d” (Plani i Biznesit)- shoqëria duhet të paraqesë në ERE, Plan Biznesin e plotë në Gjuhën Shqipe.

- Neni 9, pika 4.1.5, germa “c” (leje mjedisore) - shoqëria ka depozituar në ERE me shkresën nr. 5975 prot., të datës 27.10.2010, të Ministrisë së Mjedisit, vendimin nr. 30, “Akt-miratimi Leje Mjedisore”, lëshuar për shoqërinë “MP-HEC” sh.p.k, për HEC “Niçë”, me kapacitet të instaluar 990.72 kW”. Ky dokument rezulton të jetë lëshuar në vitin 2010 me një kapacitet të instaluar të ndryshëm nga ai që ka miratuar MIE me shkresën nr. 11965/1 prot., datë 13.12.2018, sipas projektit të zbatimit të përmirësuar dhe të ndryshëm edhe nga sa vetë shoqëria ka kërkuar të licencohet.

Shoqëria duhet të paraqesë lejen mjedisore në përputhje me parametrat e ndryshuar dhe të miratuar nga MIE, me qëllim përcaktimin e saktë të fuqisë së instaluar në rast licencimi.

- Kontrata e Koncesionit e formës BOT, me nr. 311 rep. dhe nr. 45 kol, datë 2.2.2009 “Për ndërtimin e HEC “Niçë”, ka një afat 35-vjeçar. Afati i mbetur për zbatimin e kësaj kontrate është 25 vite.

- ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Niçë”, me kapacitet të instaluar 1668 kW, për një afat 25-vjeçar.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 129, datë 29.8.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN SHOQËRISË “AYEN AS
ENERGJI” SHA, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1, dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 29.8.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 79/7 prot, datë 26.8.2019 nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për licencimin e shoqërisë “Ayen As Energji” sha në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 515/1 prot., datë 22.8.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

- Shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a., zotëron licencën për veprimtarinë e furnizimit të

energjisë elektrike me nr. 245, seria Fk14, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 83, datë 16.9.2014, për një periudhë 5-vjeçare, periudhë e cila përfundon në datën 16.09.2019.

- Në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës nga aplikanti bëhet, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë “Ayen AS Energji” sha, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”). Plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”). Plotësuar në mënyrë pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germa “a”, “b”, “c”, “e”, “d”, “f”. Plotësuar pjesërisht.

- Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7, germa “b”, “c”). Plotësuar.

- Në lidhje me azhurnimin e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 1, germa “a”.

- Nenin 9, pika 3, germa “a” (vërtetim për shlyerje tatim-taksash dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) do t’i kërkohet subjektit të sjellë vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave dhe nga Institucioni i Sigurimeve Shoqërore.

- Nenin 9, pika 4, germa “c”(lista e kontratave të mëparshme për blerjen dhe sigurimin e energjisë elektrike).

- Nenin 9, pika 4, germa “d” (informacion i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e kontratave);



- Nenin 9, pika 4.7, germa “a”. Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti.

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike, për një afat 5-vjeçarë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 130, datë 29.8.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR NJË AFAT 5-VJEÇAR (PESËVJEÇAR)

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me

vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., si dhe relacionin me nr. 79/8, datë 26.8.2019 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AYEN AS ENREGJI” sh.a., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 514/2 prot, datë 22.8.2019.

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a., zotëron licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 241, seria T14, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 79, datë 9.9.2014, për një periudhë 5-vjeçare, periudhë e cila përfundon në datën 9.9.2019.

- Aplikimi i shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a” “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me azhurnimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germa “a” (prokura e përfaqësimit të të deleguarit), si kërkesë e nenit 7, pika 2, të



“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “a” (vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore), paraqitur jo në përputhje me kërkesat e nenit 8, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Do të njoftohet subjekti që në bazë të Rregullores sipërcituar, neni 10, pika 9 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë e procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 131, datë 29.8.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELECTRAL BATRA HPP” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”, neni 5, pika 1, germa “e”, neni 10, pika 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neni 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 79/10 prot, datë 27.8.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

konstatoi se:

- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 511 prot, datë 13.8.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Neni 6, objekti i veprimtarisë së aplikuesit në aktivitetin e kërkuar për licencim: i pa plotësuar. Në objektin e veprimtarisë së aplikuesit, mungon aktiviteti i tregtimit.

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”) është i pa plotësuar.



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”) plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor “d” “e”, janë plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k. është një subjekt tregtar i regjistruar në QKB, në datën 23.12.2016, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, që mban NUIS: L62423006M dhe statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe kapitali themeltar prej 1.000.000 lekësh referuar ekstraktit të QKB-së, zotërohet nga ortakut “ALBAVIA” sh.p.k me 10 % të kuotave dhe ortakut “ELEKTRAL” sh.p.k me 90 % të kuotave.

- Objekt i veprimtarisë së saj është: “Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e HEC-eve, Batra nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, dhe transferimi i tyre në përfundim të Kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Neni 6, objekti i veprimtarisë së aplikuesit në aktivitetin e kërkuar për licencim;

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”);

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria);

- Neni 9, pika 2 germa “e” (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca);

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat “a”/“d” (sasia e energjisë elektrike e

parashikuar për tu tregtuar në GWh/sipas viteve);

- Neni 9, pika 4.8, germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti): do të kërkohet shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k. të paraqesë në ERE kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie të shoqëruar me dokumentacion mbështetës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 132, datë 29.8.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E MIRATIMIN E DRAFTIT TË RREGULLORES SË LIDHJEVE TË REJA NË RRJETIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 42, pika 3, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 16, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga



Drejtoria e Çështjeve Ligjore me nr. 79/12 prot, datë 28.8.2019, për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e draftit të Rregullores së lidhjeve të reja në rrjetin e gazit natyror,

konstatoi se:

- neni 16, pika 18, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, ERE-ja vendos standardet dhe kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit, veçanërisht për kohën që u duhet operatorëve të transmetimit e të shpërndarjes për të bërë lidhjet dhe riparimet, si dhe mbikëqyr zbatueshmërinë e tyre;

- neni 32, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, ERE-ja miraton metodologjinë dhe përcakton tarifën për aksesin në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, tarifën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, tarifën për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së dhe tarifën e furnizimit për klientët fundorë që furnizohen në bazë të detyrimit të shërbimit publik;

- neni 42, pika 3, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon gjithashtu se, OST-ja publikon kushtet dhe detyrat e miratuara nga ERE, përfshirë rregullat dhe tarifën për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit. Këto kushte dhe detyrime zbatohen në mënyrë jodiskriminuese për të gjithë klientët;

- neni 53, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi, me kusht që sistemi i shpërndarjes të ketë kapacitet të mjaftueshëm dhe të plotësojë të gjitha kushtet e tjera teknike e tregtare;

- neni 54, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron akses në sistemin e shpërndarjes, brenda kufijve të kapaciteteve të shpërndarjes dhe rregullave teknike, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, të miratuar nga ERE-ja.

- Ky dokument, i hartuar, mbështetur në sa më sipër, do të përcaktojë procedurën e

aplikimit, kriteret për miratimin dhe realizimin e një lidhjeje të re ose modifikimin e një lidhjeje ekzistuese dhe përcaktimin e tarifave përkatëse për lidhjen e pajisjeve të përdoruesit të sistemit me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes së gazit natyror.

- Draft-Rregullorja për lidhjet e reja në rrjetin e gazit natyror është hartuar duke marrë parasysh:

- fazat e hershme të zhvillimit të sektorit të gazit në vend, dhe nevojën thelbësore për zhvillimin e infrastrukturës së gazit, e lidhur kjo me domosdoshmërinë për koordinim midis planeve të zhvillimit të rrjetit dhe lidhjeve të reja;

- nxitjen e investimeve në zhvillimin e infrastrukturës së gazit;

- përvojat e disa vendeve, përfshirë vendet e BE-së, palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë por edhe jashtë rajonit;

- përvojën ekzistuese të grumbulluar në sektorin shqiptar të energjisë elektrike.

Kjo rregullore synon të sigurojë:

- zbatimin e së drejtës së secilit aplikant për t'u lidhur në rrjetin e gazit,

- tarifa lidhjeje transparente dhe të drejta,

- zbatimin e sigurt të shërbimeve të lidhjes dhe kosto lidhjeje të drejta,

- një dokument të thjeshtë dhe praktik, që përshkruhet me nivelin aktual të zhvillimit,

- një numër kërkesash minimale të cilësisë dhe afateve kohore në zbatimin e lidhjeve të reja.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e draftit të “Rregullores së lidhjeve të reja në rrjetin e gazit natyror”.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 134, datë 6.9.2019

MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË ALBPETROL SHA, PËR
LICENCIM NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 11, 23 dhe 24 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 4, pika 3 dhe nenit 11 dhe 12, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 97, datë 4.7.2017, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 79/9 prot, datë 26.8.2019 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për refuzimin e kërkesës së shoqërisë Albpetrol sh.a. për licencim në veprimtarinë e furnizimit me gaz natyror,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 89, datë 31.5.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë Albpetrol sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror, për një afat 10-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/26 prot, datë 3.6.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria Albpetrol sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 348/1 prot, datë 5.6.2019, ERE-ja ka përcjellë pranë shoqërisë njoftimin e vendimit dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit të munguar, i cili konsiston si më poshtë:

- Neni 9, pika 1 “Format dhe dokumentacioni për aplikim”:

ii) Vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave dhe drejtuesve kryesorë të shoqërisë tregtare nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.

iv. Struktura organizative dhe funksionimi administrativ i shoqërisë. Lista e

Personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin është kërkuar Licenca).

vi) Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën Licencën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisore sipas rastit për aktivitetet ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse.

- Germa “e”: Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale:

i) Deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit.

ii) Bilancin financiar të audituar nga një shoqëri audituese e akredituar, për vitin 2018.

v) Vërtetimin e kryerjes së pagesës ndaj ERE-s të Tarifës së Aplikimit në fuqi në momentin e paraqitjes së Aplikimit.

vi) Një plan biznesi i cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve.

- Neni 9, pika 2 “Dokumente specifike për llojin e licencës”

- germa, “f”:

i) Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milion Nm³, e parashikuar për tu livruar gjatë një viti.

- Në mungesë të një përgjigje dhe plotësimit të sa më sipër evidentuar, ERE-s, i është drejtuar sërish shoqërisë me shkresat nr. 348/2 prot, datë 24.6.2019, nr. 348/3 prot, datë 3.7.2019 dhe nr. 348/4 prot, datë 17.7.2019, duke i kujtuar detyrimin e plotësimit të dokumentacionit të munguar brenda afateve.

- Në përfundim të afateve, nuk rezulton që aplikuesi të ketë paraqitur në ERE shpjegime apo/dhe dokumentacionin, e konstatuar të munguar në vendimmarrjen e ERE-s për fillimin e



procedurës për licencimin e shoqërisë Albpetrol sh.a., në veprimtarinë e furnizimit me gaz natyror.

- Dokumentacioni i munguar në këtë aplikim, përbën dokumentacion thelbësor për licencimin e kësaj shoqërie, në aktivitetin e kërkuar siç përcaktuar në nenin 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë Albpetrol sh.a., për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 135, datë 6.9.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ELECTRAL BATRA HPP” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC “SELITA”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1798 KW, HEC “FRANKTHI”, 2129 KW DHE HEC “BATRA”, 2411 KW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 6338 KW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 1, 3 dhe 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,

transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 79/11 prot, datë 27.8.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, nga HEC “Selita”, me kapacitet të instaluar 1798 kw, HEC “Frankthi”, 2129 kW dhe HEC “Batra”, 2411 kW, me kapacitet total të instaluar 6338 kW.

Konstatoi se:

- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 510 Prot, datë 13.8.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Selita”, me kapacitet të instaluar 1798 kW, HEC “Frankthi”, 2129 kW dhe HEC “Batra”, 2411 kW, me kapacitet total të instaluar 6338 kW.

- Aplikimi i shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, të Kontratës Koncesionare të formës BOT, me nr. 3393 Rep. dhe nr. 1231 Kol, datë 20.12.2016 “Për ndërtimin e HEC-eve BATRA nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3”, të lidhur ndërmjet Bashkimit të Përkohshëm të shoqërisë “ELECTRAL” sh.p.k me “ALBAVIA” sh.p.k, në cilësinë e Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (sot MIE), në zbatim të VKM-së nr. 623, datë 7.9.2011 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues dhe dhënien me koncesion të HEC-eve Batra nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3



dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”.

- Nga sa konstatuar nga Kontrata e Koncesionit të formës BOT, sipërcituar, kohëzgjatja e saj do të jetë 35 vjet nga data e efektive, me të drejtë ripërsëritjeje.

- Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., në vijim të miratimit nga MIE me shkresën nr. 4510/2 prot, datë 6.7.2017, të Projektit të Zbatimit mbi HEC-et Selita, Frankthi dhe Batra, për të cilin është kryer edhe Oponenca Teknike nga AKBN-ja me shkresën nr. 1789/1 prot, datë 13.6.2017, ka depozituar në ERE dhe Kontratën Shtesë të Koncesionit me nr. 813 rep., nr. 273 kol, datë 6.9.2017: ndryshimi në kontratën shtesë konsiston në ndryshimin e fuqisë së instaluar nga $N = 5050 \text{ kW}$, në 6338 kW

- Hidrocentrali Batra nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 do të ndërtohen në rrjedhën ujore të pellgut të përroit të Zallit të Batrës, rrethi Mat. Shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k. ka depozituar në ERE certifikatat për vërtetim titulli “Në përdorim”, për pronësitë ku do të shtrihet projekti i HEC-eve në zonat kadastrale me nr. 1325 dhe nr. 1626, të rrethit MAT, të lëshuara për shoqërinë “ELECTRAL” sh.p.k dhe shoqërinë “ALBAVIA”, në cilësinë e aksionerëve të shoqërisë koncesionare. Këto certifikata janë të shoqëruara me hartën treguese të regjistrimit dhe kartelat e pasurisë së paluajtshme nga të cilat rezulton se prona që jepet në përdorim është në pronësi të shtetit.

- Konstatohet se shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k. i është drejtuar OST-së me shkresën nr. 63 prot, datë 26.10.2017, duke i kërkuar miratimin e lidhjes së kaskadës së HEC-eve të Batrës me rrjetin elektrik. OST sh.a me shkresën nr. 5734/1 prot., datë 9.11.2017, i ka kthyer përgjigje shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k duke i rekomanduar të gjejë dakordësinë paraprake me shoqërinë “Mati Hydropower” sh.p.k për integrimin e HEC-eve Batra në N/St 110/35/6.3 kV, HEC Mati 2, duke qenë se kjo e fundit është lidhur në këtë nënstacion.

- Bordi i ERE, rekomandoi marrjen e informacionit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në lidhje me vonesën në miratimin e pikës së lidhjes, dhe orientimin për të zbatuar

legjislacionin në fuqi, në lidhje me aksesin në rrjet për prodhuesit e energjisë elektrike.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa: “a”, “b”, “c”)

Rezulton se shoqëria nuk ka plotësuar Formatin e Aplikimit.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (Vërtetim nga Prokuroria që shoqëria dhe administratorët e saj nuk janë në ndjekje penale).

Neni 9, pika 2, germa “e” (Struktura e ndërtimit të shoqërisë): shoqëria nuk ka depozituar strukturën e organizimit të saj.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Shoqëria nuk ka deklaruar nëse pjesë nga fitimi i shoqërisë ALBAVIA sh.p.k do të adresohen për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe nuk ka paraqitur gjendje të llogarisë bankare, me anë të së cilës të vërtetohet se ky fitim është depozituar në bankë dhe adresuar për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

- Dokumentacioni teknik për HEC-et:

Neni 9, pika 4.1.1: Të dhëna specifike për HEC-et;

Neni 9, pika 4.1.2: Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin.

- Dokumentacioni Tekniko-Ekonomik.

Neni 9, pika 4.1.4, germa “a”: (Studimi i fizibilitetit).

Neni 9, pika 4.1.4, germa “b”: (Grafiku i Zbatimit të Projektit). Shoqëria ka depozituar në ERE si pjesë integrale të Kontratës së Koncesionit “Aneksin A” të saj, Grafikun e Punimeve, i cili parashikon ndërtimin e HEC-eve për 12 muaj, por pa përcaktuar periudhë konkrete.

Neni 9, pika 4.1.4, germa “d” (Plani i Biznesit).

- Leje nga institucione të tjera.

Neni 9, pika 4.1.5, germa “a” (Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes). Do t’i kërkohej operatorit të sistemit të Transmetimit informacion mbi ecurinë e procesit të miratimit të pikës së lidhjes për shoqërinë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k., si domosdoshmëri për vijimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie nga ERE.



Neni 9, pika 4.1.5, germa “b” (Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike).

Neni 9, pika 4.1.5, germa “c” (Leje mjedisore). Nga analiza e dokumenteve të aplikimit, në lidhje me këtë kërkesë të rregullores konstatojmë se shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k ka hasur vështirësi në lidhje me pajisjen me Deklaratë Mjedisore, pasi kryerja e VNM-së së thelluar për projektin “Kaskada e HEC-eve të Batrës”, ka hasur në qëndrimin e banorëve të zonës të cilët nuk kanë dhënë mirëkuptimin dhe dakordësinë e tyre për ndërtimin e kësaj kaskade. Më tej edhe AKM-ja me vendimet nr. 28, datë 27.6.2018 dhe nr. 38, datë 27.8.2019, ka kthyer dy herë aplikimin e shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k, duke vendosur riorganizim të dëgjësës publike për arsye se nga marrja në shqyrtim të aplikimit ka konstatuar se shumica e banorëve nuk kanë firmosur formularin për të shprehur dakordësinë e tyre për ndërtimin e kaskadës. Në vijim shoqëria “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të AKM –së nr. 38, datë 27.08.2019, duke pretenduar se dëgjesat publike janë organizuar katër herë dhe se Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Dibër, në “Raport Dëgjese me Publikun”, ka shprehur mendimin se konsulta me publikun është ezauruar pasi shumica e banorëve të zonës janë dakord. Kësaj ankesë AKM i është përgjigjur me shkresat nr. 2783 prot, datë 25.9.2018 dhe nr. 7468/1 prot, datë 26.10.2018, duke i kërkuar sërish riorganizimin e dëgjësës publike.

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” në nenin 10 pika 4 parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

- Në pikën 4, të nenit 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se:

Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera si dhe ecurinë e punimeve.

- Kontrata e Koncesionit nr. 3393 rep. dhe nr. 1231 kol, datë 20.12.2016 “Për ndërtimin e Hidrocentraleve Barta nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3”, e lidhur ndërmjet Bashkimit të Përkohshëm të shoqërisë “ELECTRAL” sh.p.k me “ALBAVIA” sh.p.k në cilësinë e Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (sot MIE), ka një afat 35-vjeçar, por në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, asnjë subjekt tregtar nuk mund licencohet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për një afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Selita”, me kapacitet të instaluar 1798 kW, HEC “Frankthi”, 2129 kW dhe HEC “Batra”, 2411 kW, me kapacitet total të instaluar 6338 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 136, datë 6.9.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENSCO TRADING (ALBANIA)” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5 pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 83/1 prot, datë 29.8.2019 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 438 prot, datë 5.7.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 121, datë 22.7.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ENSCO Trading” (Albania) sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 32/34 prot, datë 23.7.2019, si dhe me shkresën nr. 438/1 prot, datë 8.8.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 438/2 prot, datë 22.8.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat

dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikimet (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 137, datë 6.9.2019

**MBI KËRKESËN E OST SHA PËR DISA
NDRYSHIME NË “RREGULLOREN PËR
PROCEDURAT E BLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET
E SHPËRNDARJES DHE TË
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN
DHE SHITJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE, PËR TË SIGURUAR
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË
SHËRBIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, germa “I” dhe nenit”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neni 5, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar, dhe “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 214, datë 28.12.2017; nenit 21 të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”; neneve 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës, 6.9.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 67/11 prot, datë 11.7.2019 dhe relacionin shtesë nr. 79/5 prot, datë 23.8.2019, të hartuar nga Drejtoritë Teknike, mbi kërkesën e OST sh.a., për disa ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 225, datë 26.10.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për disa ndryshime në

“Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e enegjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik.

- Në vijim me shkresën nr. 55/62 prot, datë 26.10.2018, u bë njoftimi në media për fillimin e kësaj procedure duke ftuar palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre.

- Me shkresën nr. 695 prot, datë 29.10.2018, u dërgua shkresa “Marrje mendimi”, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK), Operatorit të sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe për dijeni Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), me anë të së cilës u ftuan palët për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre.

- Në përfundim të afateve për pritjen e komenteve dhe opinionëve, rezultoi se Autoriteti i Konkurrencës me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 695/1, datë 9.11.2018, përcolli opinionin e tij mbi këto ndryshime, duke deklaruar se ato nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me *e-mailin* e datës 30.11.2018, u shpreh se nuk ka komente apo opinione mbi këtë ndryshim të propozuar nga OST sh.a..

- Në vijim, ERE, në datën 27.11.2018, (njoftimi nr. 694/2 prot, datë 21.11.2018), zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të OST sh.a., OSHEE sh.a. dhe Shoqatës së Furnizuesve të Energjisë Elektrike, (AAES), në lidhje me propozimet e OST sh.a. për disa ndryshime në Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik.

- Në përfundim të seancës u la detyrë për OST sh.a. të përcjellë në ERE propozimin konkret për ndryshimin e nenit 15.

- OST sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 641/2 prot, datë 11.12.2018, përcolli propozimin konkret në lidhje me ndryshimin e pikave 1 dhe 2, të nenit 15, të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për



mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, sipas detyrës së lënë në seancë.

- Duke qenë se propozimi i sipërcituar, ndryshon nga ai që OST sh.a. kishte paraqitur në ERE, e për të cilin kishte filluar procedura, ERE me shkresën nr. 641/3 prot., datë 24.12.2018, përcolli pranë palëve të interesit MIE, AK dhe OSHEE sh.a, për opinion, nenin e ndryshuar/riformuluar nga OST sh.a, përpara se të shprehej me vendimin final mbi këtë praktikë duke i lënë afat palëve deri në datën 28.12.2018.

- Duke qenë se palët nuk u shprehën brenda afatit të përcaktuar nga ERE, me shkresën nr. 89 prot, datë 25.1.2019, ERE iu drejtua sërish palëve duke i lënë afat për shprehjen e opinionit të tyre datën 31.1.2019. Në këto korrespondenca iu kërkua OSHEE sh.a. të shprehet konkretisht nëse ndryshimi afekton procedurat që zhvillon OSHEE sh.a. për blerjen e energjisë elektrike. Edhe në përfundim të këtij afati palët nuk kanë shprehur asnjë koment në lidhje me propozimin konkret të OST sh.a.

- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 89/1, datë 5.2.2019, ka përcjellë opinionin e tij mbi ndryshimin konkret të nenit 15, duke deklaruar se ndryshimi nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

- Në përfundim të procesit të konsultimit dhe shqyrtimit të ndryshimeve të propozuara më sipër, në ERE mbërriti shkresa e OST sh.a. e protokolluar me nr. 143, datë 11.2.2019, me anë të së cilës kjo e fundit përcjell disa propozime për ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes se energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”. Me këtë kërkesë OST sh.a. ka përcjellë sërish ndryshime në pikën 3, të nenit 15 “Përsëritja e procesit të ofertës”, si saktësime të propozimit të parë, si më poshtë:

Pika 3, e nenit 15 të bëhet:

“3. Përsëritja e procesit të ofertimit duhet të njoftohet për të gjithë tregtarët e energjisë elektrike dhe të publikohet në platformën on-line dhe fagen zyrtare të blerësit.

Përsëritja e procesit duhet të kryhet të paktën një ditë pas njoftimit të dështimit të procesit.

- OST sh.a. ka propozuar ndryshim edhe në përmbajtjen e germave “a” dhe “c”, të nenit 18 “Procedura administrative e ankimit”, si më poshtë:

a) ofertuesi paraqet një ankesë me shkrim përmes platformës *on-line* ose me *e-mail* blerësit, brenda 2 orësh nga momenti i njoftimit të ofertuesit të skualifikuar ose duke u ankuar për shkeljen.

c) kur merr një ankesë, blerësi është i detyruar të miratojë vendimin për pranimin ose jo të ankesës brenda 2 orësh nga marrja e ankesës.

Edhe në këtë propozim sikurse edhe tek ai i nenit 15, vërehet se është bërë reduktimi i afatit.

- Në vijim të sa më sipër ERE me shkresën nr. 143/1 prot, datë 19.2.2019, kërkoi saktësimin dhe sqarimin e qëndrimit të OST sh.a, të rakorduar edhe më atë të OSHEE sh.a, lidhur më këto ndryshime dhe përcjelljen e tyre për miratim pranë ERE-s.

- Pas pritjes, duke qenë se OST sh.a. nuk shprehu qëndrim apo saktësim në lidhje me propozimet e tij, në datën 18.6.2019, u zhvillua seanca dëgjimore me palët e interesit MIE, A.K, AAES, OSHEE sh.a. dhe OST sh.a., të cilat shprehën dakordësinë me propozimet e OST sh.a..

- Në datën 20.6.2019, ERE-ja iu drejtua me anë të postës elektronike zyrtare, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për marrje mendimi në lidhje me ndryshimet e fundit që ka propozuar OST sh.a. në rregulloren e blerjes, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 143, datë 11.2.2019.

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë me anë të postës elektronike zyrtare të datës 26.6.2019, i është përgjigjur ERE-s dhe ka shprehur dakordësinë me këto ndryshime, që në vizionin e tij, përmirësojnë eficiencën në treg pasi janë konsultuar gjerësisht edhe me palët e interesit. Në të njëjtën kohë, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë rekomandon që ERE duhet të monitorojë zbatimin e rregullores dhe nëse konstaton se periodha e shkurtuar shkakton probleme për pjesëmarrësit e tregut ose nuk siguron nivelin e pjesëmarrjes, duhet të rishikojë sërish rregulloren.



Nga shqyrtimi i problematikës, rezulton:

- Blerja e Energjisë është e përjashtuar nga ligji i prokurimit publik duke bërë që të mos i nënshtrohet testimit të tregut në lidhje me çmimet dhe ofertat, si e tillë kjo procedurë nuk mund të bëhet vetëm me një pjesëmarrës.

- Dështimi i procedurës për blerjen e energjisë ka ndodhur 3 herë në harkun kohor të një viti.

- Në peshë specifike sasia e energjisë që prokurohet nga OST sh.a. është shumë herë me e vogël sesa ajo që prokurohet nga OSHEE sh.a., duke bërë që këto ndryshime me një ofertues të afektojnë edhe procedurat e OSHEE sh.a sa kohë kjo rregullore mbetet e njëjtë për të dy operatorët.

- Siç shprehet vetë OST sh.a këto procedura do të zhvillohen sipas kësaj rregulloreje vetëm për një periudhë tranzitore deri në funksionimin normal të Bursës së Energjisë Elektrike.

- Propozimet e OST sh.a. për ndryshimet në nenin 18, megjithëse nuk kanë qenë objekt i fillimit të procedurës, u konsideruan si saktësime të propozimit të mëparshëm dhe u morën në shqyrtim.

- Edhe pse palët u shprehën dakord për propozimin e OST sh.a. për nenin e sipërpërmendur, në gjykimin tonë, duke i qëndruar logjikës së ndryshimit të nenit 15, në përgjysmimin e kohës së përsëritjes së procesit, afatet e përcaktuara në nenin 18, pika 1, germa “a” dhe “c”, të reduktohen në gjysmën e kohës që është aktualisht në rregullore. Pra nga 24 orë të bëhet 12 orë, në mënyrë që t’u jepet mundësi të gjitha palëve të kenë kohë të mjaftueshme për të ushtruar të drejtën e tyre për ankimim dhe për të mos penguar OST sh.a. për përsëritjen e procesit. Sa më sipër argumentohet edhe me faktin që në rastin e OSHEE sh.a ankimi bëhet direkt në platformën *on-line* dhe është i justifikueshëm afati prej 2 orësh, ndërkohë platforma e OST sh.a nuk e ofron këtë mundësi.

- Ndryshimet e propozuara nga OST në nenin 15 pika 1, që konsistojnë në:

- Në rastin e përsëritjes së procesit, procesi të zhvillohet i njëjtë me atë fillestar dhe procedura të përsëritet aq herë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, blerjes së sasisë së nevojshme të energjisë.

- Procesi mund të konsiderohet i vlefshëm dhe me një ofertë të vlefshme.

Sqarojmë se:

- Blerja e Energjisë është e përjashtuar nga ligji i prokurimit publik duke bërë që të mos i nënshtrohet testimit të tregut në lidhje me çmimet dhe ofertat, e si e tillë kjo procedurë nuk mund të bëhet vetëm me një pjesëmarrës.

- Dështimi i procedurës për blerjen e energjisë ka ndodhur 3 herë në harkun kohor të një viti.

- Në peshë specifike sasia e energjisë që prokurohet nga OST sh.a. është shumë herë me e vogël sesa ajo që prokurohet nga OSHEE sh.a., duke bërë që këto ndryshime me një ofertues të afektojnë edhe procedurat e OSHEE sh.a sa kohë kjo rregullore është e njëjtë për të dy operatorët.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për ndryshime në nenin 15, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e blerjes se energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

2. Të miratojë pjesërisht ndryshimet e propozuara nga OST sh.a si më poshtë:

b) neni 15, pika 3, e “Rregullores për procedurat e blerjes se energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, ndryshon:

Përsëritja e procesit të ofertimit duhet të njoftohet për të gjithë tregtarët e energjisë elektrike dhe të publikohet në platformën *on-line* dhe faqen zyrtare të blerësit. Përsëritja e procesit duhet të kryhet të paktën një ditë pas njoftimit të dështimit të procesit.

c) Neni 18, pika 1, germa “a”, e “Rregullores për procedurat e blerjes se energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, ndryshon:

brenda 12 orësh nga momenti i njoftimit të ofertuesit të skualifikuar, ofertuesi paraqet një ankesë me shkrim përmes platformës *on-line* ose me *e-mail* blerësit, duke u ankuar për shkeljen.



d) Neni 18, pika 1, germa “c”, e “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, ndryshon:

kur merr një ankesë, blerësi është i detyruar të miratojë vendimin për pranimin ose jo të ankesës brenda 12 orësh nga marrja e ankesës.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 138, datë 16.9.2019

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë

elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017 i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 16.9.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përparatur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin gusht 2019, nr. 90/6 prot, datë 12.9.2019,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a, me shkresën nr. 17919 prot, datë 23.8.2019, paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin gusht 2019.

- Nëpërmjet këtij aplikimi, OSHEE sh.a. kërkon që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të klientët e FMF-së, për muajin gusht 2019, të jetë 12.75 lekë/kWh.

- Llogaritjet e OSHEE sh.a., si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin gusht 2019, sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi per FMF per muajin Gusht 2019

Gusht 2019		Aplikimi OSHEE Sh.a	Propozimi i ERE
		Njësia	Çmimi
a	Cmimi maksimal I blerjes ne treg te parregulluar ose blerja nga prodhuesit me perparesi	Leke/kWh	8.4582
b	Kthimi per riskun I percaktuar ne perqindje per vitin (3%)	Leke/kWh	0.25
c	Cmimi maksimal I blerjes ne periudhen relevante	Leke/kWh	8.71
d	Kosto administrative te Furnizuesit te Mundesise se Fundit	Leke/kWh	1.79
e	Tarifa e perdorimit te rrjetit te transmetimit	Leke/kWh	0.75
f	Tarifa e perdorimit te rrjetit te shperndarjes	Leke/kWh	1.50
Cmimi I energjise (c+d+e+f)		Leke/kWh	12.75



OSHEE sh.a, për muajin gusht 2019, ka zhvilluar 1 procedurë për blerjen e energjisë nga tregu i parregulluar, ku çmimi maksimal i blerjes së energjisë elektrike, për muajin gusht 2019, prej 62.99 Eur/MWh, i përket energjisë elektrike të blerë nga shoqëria EFT AG Loti 1, realizuar në datën 26.7.2019 për sasinë totale prej 11,904 MWh me një vlerë prej 749,832.96 euro ose 90,804,771 lekë.

Nga analiza e informacionit mbi procedurat e blerjes së energjisë elektrike të dorëzuar nga OSHEE sh.a. me shkresën nr. 16355 prot, datë 30.7.2019 dhe protokolluar në ERE me shkresën nr. 28/4 prot, datë 2.8.2019 për çmimin FMF për muajin gusht 2019, data 26.7.2019 është dita e mbylljes së procedurës së blerjes nga tregu i parregulluar për të cilën kursi i këmbimit sipas raportimeve të Bankës së Shqipërisë rezulton 1 eur = 121.7 lekë.

- Në aplikimin për çmimin FMF për muajin gusht 2019, OSHEE sh.a. ka zbatuar me korrektësi përcaktimet e nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 të bordit të ERE-s, për sa i përket çmimit maksimal të blerjes.

- Meqenëse çmimi i realizuar nga blerja në tregun e parregulluar (7.67 lekë/kWh) ka rezultuar më i ulët se çmimi i blerjes nga prodhuesit me përparësi (8.4582 lekë/kWh) i miratuar me vendimin nr. 8, datë 17.1.2019 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019” të bordit të ERE-s, ky i fundit është marrë në konsideratë nga OSHEE sh.a. për llogaritjen e çmimit të FMF për muajin gusht 2019.

- Shoqëria vazhdon të mos ketë ndarje të llogarive midis aktivitetit të Furnizimit dhe Shpërndarjes dhe nuk ka një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe kostove të disbalancave për klientët e FMF.

- Gjendur në kushtet e pamundësisë së ndarjes së kostove të FMF nga ato të FSHU mendojmë se, për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës) është e arsyeshme të pranojmë koston për njësi prej 1.79 lekë/kWh të paraqitur nga OSHEE sh.a.

- Shoqëria OSHEE sh.a., informon se duke filluar nga muaji korrik 2019 për të gjithë klientët FMF-së janë marrë masat e faturimit me të njëjtën tarifë si për energjinë në Pik dhe atë Aktive. Në vendimin nr. 126, datë 8.8.2019, bordi i ERE-s vendosi që shoqëria OSHEE sh.a. duhet të bëjë korrektimin, për të gjithë faturimet e kryera në Pik për gjatë gjithë periudhës që OSHEE sh.a. ka ushtruar funksionet si Furnizues i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në 35 kV.

- Për sa më sipër, ERE bëri analizën dhe verifikimin e strukturës së shitjes të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për muajin Korrik 2019 sipas raportimeve periodike të dërguara nga OSHEE sh.a. me shkresën nr. 18024 prot, datë 27.8.2019 (protokolluar në ERE me nr. 113/7, datë 29.8.2019). Nisur nga vlera e të ardhurave të realizuara nga shitja e energjisë në pik prej 226,376 lekë dhe sasia e energjisë së shitur në pik prej 17,755 kWh rezulton se çmimi i aplikuar në pik është 12.75 lekë/kWh, i njëjtë me atë të miratuar nga ERE për muajin korrik, gjë që konfirmon se shoqëria ka ndërprerë praktikën e faturimit me çmime ndryshe nga miratimi për energjinë në pik.

- Në zbatim të vendimit nr. 126, datë 8.8.2019, të bordit të ERE-s, shoqëria OSHEE sh.a. shprehet se ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të ERE-s për rimbursimin e klientëve të FMF-së duke identifikuar numrin e klientëve dhe impaktin financiar që ka patur faturimi i energjisë pik me çmim më të lartë se ai energjisë aktive dhe do të vijoje me rimbursimin financiar të tyre.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 266, datë 21.12.2018 të bordit të ERE “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për vitin 2019” është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 268, datë 21.12.2018 të bordit të ERE “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është 1.5 lekë/kWh.



- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlogaritëse rezulton që çmimi i shitjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2019, të jetë 12.75 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 12.75 lekë/kWh, për muajin gusht 2019.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr. 118, datë 9.7.2019, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetases Suela Buça dhe caktimin si kujdestare të saj, shtetasen Mire Buça.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë